

85H-211.5-2

H 22



# **HALLET E DASMÉS**

83 891.983-211.58-2  
H22

5

S

# HALLET E PASMËS

*Tregime satirike*

*kundër bestyinive dhe zakoneve të këqia*

2028 4311  
LIBRERIA E SHTETIT  
GJIRORASILCE

SHTËPIA BOTONJËSE «NAIM FRASHËRI»

## DULLË KASEMI

Kjo që po tregoj ka ndodhë tash vonë, diku, andej kah katundet e Fushë-Krujës, kufi me Ishëm.

Dullë Kasemi, që ta merrni vesh ju, po ja luente fenë rehatisë, simbas hesapit të vet. Hoq pak keq nja tri-katër vjet mbas vdekjes së grues, derisa Bimi, i biri, u ba i zoti i tokës dhe Laja, e bija, mori shtëpinë në dorë. Atëherë Dulla na hoq dorë fare si nga puna e bujqësisë, si edhe nga telashet e shtëpisë. Gjithë ditën flladitej hieve, ndante davatë e fshatit dhe jepte këshilla për dobinë e madhe që sjell puna. E pra, nuk ishte i vjetër. Shokëve të tij pesëdhjetëvjeçarë u shkonte djersa për lug të shpinës, tue pune gjithë ditën.

Dulla, që të mos harrojmë, kishte dhe një huq tjetër. I pëlqente të kishte në sofër gjana të mira dhe të hante shumë. Për pu-

në heje nuk e kursente lekun. Prandej ishte trashë e shëndoshë me pasë njeriu dëshirë ta shikonte.

Për t'u martue, ma Dulla s'u martue, se si e thonte edhe vetë, nuk desh t'i përziente fëmijët. Për këte trimni dhe përm habetin e tij të ambël si sheqeri, fshati e mbante Dullën një copë burrë dhe e nde ronte.

Kështu po kulloste Dulla qetë-qetë, deri sa nisi të vlojë nëpër fshat puna e kooperativës. Sa përm nuhatës dhe i zgjuet Dulla nuk i linte gja mangut ma të mirit. Ai e kuptoi menjëherë se në kooperativë duhej punë e jo pallavra. Atje nuk shkonte ma as muhabeti i ambël, as flladi i pemëve. Nde nji e vëzhgoi një herë se çfarë shkaqesh do të nxirrnin ata, që nuk e donin kooperativën si ai. Si shkaqe dolën pothuej se këto:  
— «Jo kam një shtëpi përm të ndreqë ma parë, jo do fejoj djalin e të martoj vajzën, jo nuk don njeni vëlla e nuk mund të ndahemi, e dokrra të tillë». Dulla i peshoi të gjitha këto arësydhe asnjena nuk iu duk e përshtatshme. U mendue mirë dhe në fund e gjet shkakun. U shti i sëmunë.

Djali e vajza, të shkretët, u banë pikë e vnerë përm këte sëmundje kaqë të papritun.

Sëmundja, siç thoshte Dulla, ishte shumë e randë, i jepte sëkëlldi të madhe, mezi e linte të ngrihej në kambë. Por prapë Dulla i falej nderës Zotit, që kjo sëmundje nuk ja kish pre oreksin e bukës. Hante prapë si përpara, bile herë-herë ma tepër se përpara. Edhe katundarët çuditeshin se ç'dreq sëmundje ishte kjo, që ta fikte sofrën.

Ja si tregonte një shok i tij, Tafë Ceni, kur pat shkue me i ba një vizitë.

— Ishte mëngjes, — thotë Tafa. — Dulla kishte ndenjë përmbi dyshek të butë, tamam si derri majun mirë.

— He, more Dullë, — e pyeta. — Si e ndjen veten?

— Zoti mos ja qitet kujt për hise këtë sëmundjen time, o Tafë, — m'u përgjegj.

— Po ku të dhemb, mor i shkretë!

— Ku nuk më dhemb, thuej ti. Trupin s'e ndjej fare. Më merret fryma. Kambët s'më punojnë. Veçse jam gjallë kot.

— I shkreti ti, ç'të gjet, — i thashë. Ishe shëndoshë si lis. Po me hangër a mundesh?

— Sa me mbajtë frymën gjallë e me heqë si po heq.

Në këtë kohë hyni Laja, e bija, me një tepsí në dorë. Shikoj unë: mbi tepsí, një tas një kilosh me qumësht dhe një çerek buke.

Unë, gjithnjë se po ma sjell mue për mëngjes: — Të falem nderës, unë hangra te shpija para se të vija, — i thashë.

— Jo, asht mëngjesi i babës, — tha vaja-za e u turpnue.

— E solle, moj bijë, të pastë baba, — tha Dulla pa çà kryet për sa fola unë. T'iu shtrue tepsisë kadalë-kadalë, pa fjalë, pa më dhanë fare muhabet.

— Shiko, më sill edhe një copë djathë, — e porositi vajzën, kur kjo u nis me dalë.

— Mos po të ban keq, more babë, — iu përgjegj Laja.

— Jo, ishalla, s'i kam ba keq kujt, që të më ndëshkojë Perëndia në këtë mënyrë. Sill, bijë, djathin, sill edhe një tas mjaltë.

— Mos po shkon pak si shumë, — mur-muroi vajza.

— Po ç'janë këto për një të sëmunë, moj bijë? — iu përgjegj i ati.

— Kurrgja besa, — thashë me vete — Jo, vërtet, mos ma qitët Zoti për hise këtë sëmundje, se kur të duesh dal me këpucë të kuqe.

Ja pra, kështu e kish rregullue sefanë Dullë Kasemi. Edhe ja kishte vaktin: djali iu ba puntuer i madh. E bante punën sa për tre vetë. Babën mandej e donte shu-

më dhe s'e lente mangut për kurrgja. E çfarë i duhej Dullës kooperativa?

— Do të jesh shumë ma mirë në kooperativë, — i thonin ata që vinin t'ja mbushnin mendjen. — Dulla queshte nën mustak e thonte me vete:

— Ik, or budalla! Ku ka ma mirë se kështu? — Këte, siç thashë, e thonte me vete, kurse atyne u përgjigjej me za të përvajshëm:

— Ç'i duhem kooperativës unë kështu, i sëmunë, more djem? Kooperativa don punë, don shëndet. Unë jo vetëm, që s'punoj dot, por ja kam zanë kambët edhe vajzës së shkretë, që duhet të më bajë hyzmet. E Bimi vetëm si mund të na mbajë ne të treve. — Nga goja Dulla kish ndodhë bilbil. Atje ku prekej sadopak sefaja dhe interes i tij, e mbronte veten për t'u habitë.

Kështu shkoi do kohë e mirë. Të gjithë tashti e mbanin të sëmunë Dullën. Pat ardhë një mjek ta shikonte, por nuk i gjeti gja me randësi. Atëherë e mbrapa Dulla bërtiste se as mjekët s'ja gjejnë dot sëmundjen. Mirëpo ku durohej në shtëpi kjo sëmundje kaqë e rrezikshme për xhepin? Bimi i shkretë babën e donte shumë, por deri kur do ta duronte në këte mënyrë? U për-

poq këndej e andej, por asnjeri s'i binte në të kësaj sëmundjeje. Njatje vonë, si filluen të rrallohen ata që vinin për punë kooperative, Dulla sikur nisi të bahej ma mirë. Mirrte shkopin dhe dilte nga pak nëpër katund. Mirépo nuk zgjaste dhe prapë në fshat ndizej puna e kooperativës. Dulla përnjëherësh bahej i sëmunë. E ndjente punën e kooperativës, siç e ndjen reumatizma motin e keq. Këte gja nisi ta vejë re edhe Bimi. Zu t'i hyjë njëfarë dyshimi se mos baba shtihej i sëmunë. Prapë nuk ja priste mendja se baba i tij mund të bante një punë të tillë.

Fshati s'e pyeti Dullën, u ba kooperativë dhe nisi t'i punojë tokat me traktor. Si traktorist erdhi në fshat një farë Myrteza Kasemi po prej Fushë-Kruje dhe kushëri i dytë me Bimin. Mësasi në këte fshat ai nuk kish njeri më të afërm se Dullën, ra në shtëpi të tij. Aty hante, pinte dhe lahej e veshej. E bani shtëpinë e Dullës tamam si shtëpinë e vet. Ky Myrtezai na kish qenë dreqi vetë. Kish mbarue kurs për infermier, për teknik bujqësor, për llogaritar dhe në fund për traktorist. Në Krujë ai kish marrë pjesë edhe si aktor nëpër grupet diletante. Dinte pra po thuej çdo gja. Gojën e kishte brisk. Kudo që ishte ai kristë gazi e kanga.

Laja dhe Bimi gjëzoheshin shumë që e kishin në shtëpi dhe e mbanin në shuplakë të dorës. Myrtezait i ra të rrijë në ate shtëpi disa ditë të mira. Atje ai vuni re shumë gjana. Vuni re, për shembull, se Dulla nuk kish sëmundje tjetër veç ate të përtacisë; e jo vetëm ate, por edhe sëmundjen e grykësisë. Këte ja tha një natë Bimit, të cilit iu përtri, edhe një herë dyshimi i vjetër. I vuni vëlla e motër ta vërenin mirë punën e tij. Me të vërtetë, ata vunë re se, kur nuk kish njeri në shtëpi, Dulla ecte për bukurinë bante disa punë, që s'i bante kurrë kur kish njeri afër. Laja e kish pa tue hypë në pemë për me marrë rrush, tue ça dru për me fërgue ve, e tjera e tjera. Si u bindën vëlla e motër, Myrtezai vendosi ta shëronte Dullën dhe t'i shpëtojë njëherë e mirë ku shërijtë e tij të largët. I tha Bimit të hapte fjalë se po shkonte në Tiranë, për t'i sjellë babës një doktor shumë të përmendur. Porositi Lajen t'i prentonte babës një drekë me të gjitha të mirat. Vetë i la lamtumirën Dullës, se do të shkonte në një kooperativë tjetër për punë.

Të nesërmen, Laja preu një pulë që që ma e majmja. Holloi një byrek, zjeu një pilaf që kullonte nga tlyni, edhe poq një

hallvë. Dulla me shkop në dorë mundohej ta ndihmonte të bijën. Për punë të tilla diku e jepte ndihmën e vet edhe pse ish i sëmunë. Ishte gjithë qejf për drekën që po pregetiste e bija, por ja prishte pak ai mjek, që do të vinte ta vizitonte.

— Jo, moj bijë, jo, nuk ka mjek që më shëron mue, — i thonte Lajes. — Kam sëmundje të keqe unë. Ka mbarue puna ime. E shof vorrin që po më hapet. Të ha bile mirë e të shkoj i ngopun.

— Qoftë larg, — thërriste Laja. — Ç'janë këto fjalë, o babë? Ti je si rrunzak. Doktori do të të japë disa ilaçe dhe do ta heqë shkopin fare.


Si u banë gjellët gati ja mbërrini doktori. Kish gjetë ky Myrtezai një palë musteqe, një palë vetulla dhe një palë syza e na ishte ba, bane be, se asht doktor.

— Si je, o xhaxho? — pyeti Dullën, sa hyni mbrendë.

— Siç po më shef, o doktor, — iu përgjegj Dulla, ashtu si flasin të sëmunët.

— Pa dale të të shikoj pak, o xhaxho, — i tha Myrtezai tue ndryshue gjuhën. I mati pulsin, i vuni fenendoskopin<sup>1)</sup> në shpi-

1) — Aparati që përdorin mjekët për të dëgjuar më mirë organet e të sëmurit.



në e në gjoks, e bani me u kollitë, i shikoi  
gjuhën, thonjtë dhe e pyeti se mos kish  
hangër gja tashti në mëngjes.

— Jo, — iu përgjegj Dulla përmallshëm.  
Po gënjenate sa kishte kokën.

— Shumë mirë, shumë mirë! — tha mjeku.

— Si duket, shoku doktor? — e pyeti Bimi.

— Nuk i ka punët në rregull, — foli mjeku, tue luejtë kryet. — Keq, o xhaxho, keq — iu drejtue Dullës.

— E di, more bir, — psherëtiti Dulla, dhe me mend i tha: Faqen e zezë di edhe ti, se unë jam shëndosh si topi. — Mirëpo ke pa ti që, edhe pse e dinte se s'ka kurrgja, këto fjalët e mjekut filluen t'i ngulen si gozhdë në krye? Mjek ishte ai. Mirë o keq, një shkollë e kishte krye.

— A ha shumë ti, xhaxho? — e pyeti për çudi mjeku.

— Sa me mbajtë frymën, more bir, — përgjegji Dulla.

— S'e besoj! — bërtiti me të madhe ai. — Kurrë nuk e besoj! Ju kërkonitë fshihni të vërtetën. Unë iu betohem, që ky ka sëmundjen e quejtun në gjuhën mjekësore, llupsis ngranafortis.

— E ç'asht kjo sëmundje, shoku doktor? — e pyeti Bimi.

— Sëmundje, që vjen nga ushqimi i te-përm.

Dullës gati sa s'i ra pikë nga këto fjalë.

Doktori po thonte të vërtetën, por në anë tjetër kjo e vërtetë po i prekte pikërisht ushqimin, për të cilin Dulla linte kokën.

— S'asht gja ai llaf; — foli Dulla, tue harrue ta bante zanin si i sëmunë. — Si po u sëmundka njeriu prej ushqimit? Mandej, sikur po ha tepër unë!

— Unë kështu po të them, o xhaxho, iu përgjegj me inat mjeku. — Kjo sëmundje, që ke ti mos i raftë as anmikut. Ti thuej shqyr që po i bjen mbrapa me kohë, se përndryshe do shkoje te shokët.

— E pra, baba ynë nuk han aqë shumë, shoku doktor, — ndërhyjni Bimi dhe i luejti synin.

— More, nuk ma mbushni mendjen kurrsesi — bërtiti prapë mjeku. — Shkenca nuk më gënjen kurrë. Ja, shikoje si asht trashë qafa.

— Po mandej? — Pyeti Dulla, tue u mundue ta zinte ngushtë mjekun.

— Do të thotë se ka hangër pula të pjekuna.

— E ç'të keqe kanë pulat e pjekuna?

— Si ç'të keqe kanë!? S'e shikon veten si je ba, që nuk luen dot vendit? Pastaj, shiko si të varen gjitë, si me qenë grue e pjellun. E pse kështu? Nga byrekët e shum-

të, që ke hangër. Ja, ky lloj barku tregon fare kjartë se ti han sa mundesh djathë, ve të fërgueme, mish të majm, turshi... Po ambëlsiná i jepni? — pyeti Bimin.

— Ambëlsinat ja kande shumë, — tha Bimi, — por nuk kemi pasë mundësi t'ja japim sa herë që ja kërkonte mideja.

— Ah, ju jeni katila, — bërtiti me të madhe mjeku. — Ju doni të mbysni babën. Po me sa palë mend i jepni ambëlsinë ju këtij?

— Po ku e dinim ná se i bakan keq, — tha Bimi.

Ky doktor, i dukej Dullës, me të vërtetë i kish ra në të sëmundjes, por përsa u takon ëshqimeve po fliste përcart. E, menjëse në punë të të ngrënët nuk kishte qejf t'i përzihej kush, iu përvesh si duhet.

— More doktor, ti më duket nuk qenke në vete. Mue më kanë pa edhe doktorë të tjerë, po asnjeri nuk më ka folë kështu si flet ti. Bile, kur e pata pyetë doktorin e qytetit se çfarë të ha, ai më tha ha çfarë të duesh, se stomakun e ke të fortë si guri.

— Po a të shëruen doktorët e tjerë? — pyeti me ironi mjeku.

— Jo, — u përgjegj Dulla.

— Ja pra, si re vetë mbrendë. Unë nuk

të them s'ké gja, si të kanë thanë ata. Unë  
të them ke, e bile je në rrezik të madh.  
Llupsis ngranafortis, s'i thonë shaka. Kjo  
sëmundje të çon ke të shumtit kur nuk e  
mendon.

— Aman, doktor, kërko sa të duesh,  
veç na shëro babën, — tha Bimi me za si  
në vaj.

— Për të punue a punon babai juej?  
— pyeti mjeku, si u mendue mirë ma parë.  
— Po ku mund të punoj unë me këtë  
sëmundje në trup? — iu përgjegj gjithë  
inat Dulla.

— Po para se të sëmunesh, ke punue?  
— Baba ka pesë vjet që e ka shkrehë  
fare punën, — ndërhyjni Bimi.

— Kuptova, — pëshpëriti mjeku. Asht  
e natyrshme. Njena sëmundje sjell tjetrën.  
Sëmundja Llupsis ngranafortis ka sjellë me  
vete sëmundjen tjetër, po aqë të rrezikshme,  
që ne mjekët e quejmë, me termë shken-  
core, Dembelitis akutis.

— Po kjo sëmundje ç'na qënka? —  
pyeti me një gjysmë talljeje Dulla.

— Njeriu i tërbuem e ka frikë dhe e  
urren për vdekje ujin, — spiegoi mjeku.  
— Pra, edhe kjo sëmundje asht një lloj  
tërbimi, por jo vdekjepruse si tërbimi i vër-

tetë. I prekuni nga kjo sëmundje ka frikë  
dhe e urren për vdekje jo ujin, por punën. I  
pëlqejnë hiet ku rreh flladi, gurrat e fres-  
këta dhe muhabeti. Pa ngreu pak, të lutem,  
— i tha Dullës, i cili u ngrit me naze, si  
i sëmunë që ishte. — Ecë pak! — Dulla zu  
të ecë. — Mjaft, mjaft, — thirri mejku.  
— Ajo vetë asht. Dembelitis akutis.

Po në këte kohë na hyn në dhomë Laja  
me një tepsi plot ushqime. Një pulë e pje-  
kun, një sahan pilaf, një tas me hallvë dhe  
një grumbull, si kala, me rriska byreku.

— Po kjo? — Thirri gjithë zemërim  
mjeku.

— Solla drekën, zotni doktor, — foli  
Laja me krye ulë, si e lypte mirësjellja.

— Po sikur asht pak herët për drekë.  
— Babai gjithnjë e han herët drekën,  
— spiegoi Laja.

— Protestoj, protestoj, — thirri me të  
egër mjeku dhe rrahu shkelmat për dyshe-  
me. Laja mbet si e çuditun. — Ju doni ta  
mbysni babën me duert tueja. Ju edhe më  
gënjeni. Më thoni se baba han fare pak. Shi-  
kon si çfarë i sillni për drekë.

— Si flet ashtu, zotni doktor? — Kë-  
ceu Laja. — Si dashkemi ne të mbysim  
babën? Ne mezi e kemi.

— Shpejt, hudhini poshtë ato ushqime, urgjent, — urdhënoi mjeku.

Dullës së shkretë gati sa s'i ra pika. Për pak desh t'i sulej tepsisë, por e mbajti veten.

— Si more t'i hudhish poshtë! — thirri tue fsha nga fundi i zemrës.

— Atëhere ulu e ha ti xhaxho, e unë nuk kam ma punë këtu. Kështu tha i vendosun, u ngrit e mori kapelën rrogoze, që kish heqë kur hyni.

— Aman, doktor — briti Bimi dhe e ndaloi për krahu.

— Më lëshoni — bërtiste mjeku. Nuk kam punë me njerëz që duen të mbysin babën.

Nga këto fjalë Dulla i shkretë erdh e u ba derr nga inati. Mallëkonte të birin, që u përpoq në këtë doktor të çmendun, i cili kërkonte ta vdiste për bukë.

Bimi e ndaloi mjekun. U vendos, që gjellët të mos hidheshin poshtë, por të haheshin aty, mbasi ishte kohë dreke. Doktori pranoi me njëmijë halle, por ma parë u sigurue që baba nuk do të shtinte në gojë asnjë kafshatë prej tyne.

Merrnie me mend çfarë ndjenjash të çuditshme po provonte Dulla i shkretë, tue

shikue djalin, vajzën e mjekun, që hanin ato gjellë aqë të mira, pa qenë i zoti me e shkye, qoftë një kofshë pule prej tyne.

— Shumë e mirë paska qenë kjo pulë,  
— tha mjeku tue shti në gojë një llokëm,  
që kullonte nga yndyra.

— Ha, o vëlla, ha — thonte Dulla me vete, tue e shikue përmallshëm, — se paska qenë shkrue të hash rriskun tim.

— Pula dhe gjellët po haheshin dalgadalë. Dulla herë pas here i lëshonte nga një sy shqyrtyues sofrës. Kur e pa se ata të tre e kishin vu mendjen të mos linin gja në sofër, erdh e u ba si i tërbuem. U ngrit në kambë dhe hyni në mes.

— Dale, more, — u thirri. — Ku keni pa të hani ju dhe unë të rri e të shikoj?

— Po ti je i sëmunë, more babë? — i tha Laja me një gjysmë zani.

— Nuk jam aspak i sëmunë, — iu përgjegj Dulla.

— E di unë — thirri mjeku.

— Ti din faqen e zezë, — iu përgjegj Dulla.

— Po atëherë pse s'punon? — E pyeti prapë mjeku.

— Pse nuk më pëlqen, — iu përgjegj Dulla.

— Pra, ti më paske rrejtë se je i së-munë! — i foli prapë mjeku.

— Të kam rrejtë, që ç'ke me te, por shtyju pak të ulem edhe unë në sofër.

— Ama kështu na qenka puna! — thirri mjeku, dhe papritmas hoq syzat, mustakët, vetullat e doli Myrtezai i vërtetë. Bimi dhe Laja ikën nga sofa, tue e dijtë se do të kristë potera. Kur ngriti kryet Dulla dhe pa Myrtezain, erdh e t'u hakrrue sysh nga tërbimi, sa Myrtezai e pa t'udhës të ngrihej nga vendi.

— Po ti paske qenë, more jezit, — thirri një herë Dulla dhe kërkoi këndeje an-dej ndonjë gja, që ta gjuente. Myrtezai duel prej dere. U ngrit edhe Dulla dhe doli në derë. Atje larg, mbas pemësh, pa Lajen dhe Bimin që po ikshin tue qeshë. Kjo gja e tërboi ma tepër.

— Thyej qafën nga shtëpia ime, mor rezil, mor maskara, — e shau Myrtezain. — Mue më nderon fshati e ti të tallesh me mue?

— Po më përzen, o xhaxho? — i foli me të butë Myrtezai.

— Ikë, se emni i allahut, po të zuna, t'i theva kambët.

— Mirë, unë do të ikë dhe do t'i tre-

goj gjithë fshatit se ç'ndodhi me ty. Do t'i them se ti s'je i sëmunë aspak, por nuk të pëlqen të punosh, nuk të pëlqen kooperativa, se atje të kërkojnë punë. Do t'i them se ty të pëlqen të hash në kurriz të fëmijëve të tu. Do të shohësh, a do të të nderojë ma fshati. Lamtumirë, xhaxho.

Këto fjalë ja banë dhallë mendjen fare Dullës. Nuk lypej tjetër, veç njato fjalë të fliste Myrtezai dhe puna e Dullës merrte fund. Njeri nuk do t'ja varte ma torbën, bile as do t'i flitshin me gojë. Desh s'desh u suell ca kohë i vetëm nëpër dhomë, ashtu si demi rrëth gjakut dhe, në fund, e pa ma të drejtë të veprojë me mend e jo me gjak-nxehtësi. Doli prapë në derë. I shikoi të tre, që po rrinin nën hijen e një kumbulle. Myrtezai, sa e vuni re Dullën, u ngrit dhe i duel para.

— He, xhaxho, a po na pranon?

— Eja, mor eja, eja mor laiku im, — thirri Dulla dhe pa dashë e bani buzën në gaz. — Eja. Bani si të doni, veç mos ma merrni fytyrën në fshat.

Të nesërmen Dulla gdhini kooperativist. Kur e mësoi fshati ngjarjen e asaj dreke, qe shumë vonë se Dulla ishte shërue sëgjithash. Ai shquhej tashma si një nga punëtorët ma

të mirë të brigadës së vet dhe herë herë ua tregonte vetë shokëve ate që i punoi «doktor» Myrtezai, kur ata e ngacmonin. Dulla tregonte bukur dhe i bante të gjithë me qeshë. Ai tregonte dhe shkrihej gazit edhe vetë me Dullën e asaj kohe, sikur ajo që tregonte të mos i përkiste fare atij, por dikujt tjetër, i bindur se shokëve të brigadës as që mund t'u shkonte ndërmend ma ta ngatronin Dullën e asaj kohe me Dullën që kishin parasysh.

Pa e kuptuar edhe vetë Dulla bënte kështu autokritikën ma të sinqertë.

## HALLET E DASMËS

Thëngijtë e hollë prej krandesh, tue u copëtue e tue u mbulue nga nji cipë e bardhë, ishin shkri në hirin e votrës. Llamba ndriçonte zbetë. Në muret e odës çfaqeshin, si në perden e filmit, hiet e tyne, lëvizjet e duerve në forma të papërcaktueme, të çuditshme.

Ata vazhdonin muhabetin, tue ba llogari mbas llogarish me mend e me gishta. Burrë e grue qajshin hallin e dasmës. Kjo ishte një nga ngjarjet ma të shënueme. Do të martojshin djalin. Dita e Shëmrisë asht ditë dasme. Dhe ja, tri netë kanë ngelun. Të nesërmen ishte e enjte. Simbas zakonit, Idrizi do t'i conte mikut mishin e dasmës. Dy dele shterpa e nji cjap të vjetërue i kiste caktue për mikun. Për vete do të therte një mëzat. Në ahur i ngelnin vetëm gomari

e lopa. Herë mbas here, ai zgjidhte nji spango me të cilën kishte shtrëngue çantën prej meshini dhe rrinte tue numrue edhe ato pak të holla që i kishin ngelur.

Harxhet e tjera i kishte ba të gjitha. Kushedi prej sa kohësh kishte fillue pregatitjet. Muhabeti u kishte zanë vend pa i dhanë zgjidhje. Po sikur të mos i pranonte miku ato bagëti, çfarë do të bajshin? Borxh nuk kishte kujt me i kërkue. Boll ma. Ish-te mbush deri në fyt me borxhe. Po përpinqeshin të gjenin edhe nji shpresë ku të kape-shin. S'ishte shaka të preqatiteshe për dasmë e mos ta bajshe. Sa vetave u ka ngja! Për nji gja të vogël miku ta shtyn nji vit. Edhe djalit mezi që i kishin marrë leje, se i kishte ardhë fletë-thirrrja për ushtar. U banë gadi me ra. Shuen llambën. Poçi i saj ishte nxi e drita mbrenda errej krejt. Kiske-te kalue mesi i natës.

Të nesërmen Idrizi lidhi bagëtitë me atë brezin e kuq, që shtrëngonte mullën, tue ba disa herë bismilahin, e u nis për në pazar. Do të qetëj e të rruhej se flokët e kishin mbulue, aq sa kësula me atë rrëthim e zi të yndyrtë i qëndronte në majë të kokës. Ekte tue têrhekun bagëtitë, i futun thellë në mendime për hallet e dasmës: «Më këputi

krejt e shkreta, por ma në fund po e mbë-shtjell me emën të Zotit. Mor shyqyr... Ke dhanë ç'ke dhanë pare... E kush s'jep pare pér të pru nji njeri mbrenda? A pyes unë se më ik djali ushtar? Hiç, pér Zotin. Apo s'asht punëtore?... Ku di sa ditë punë kishte futun atje, në koperativë?! Ajo po e mban Selimin, se ai s'punon fare. Asht ba si derri... Fërkonte duert tue shtrëngue mirë brezin e tue u lëshue nga nji britmë me za të hollë bagëtive. Kishte mrrijtë në pazar. Si pér tersllék, sot kishte njerëz kiamet. Ata kalojshin tue këndue e tue kërcye rrugës. Zhurma e daulleve shpërndahej nëpér gjithë qytetin. Idrizit filloj t'i prishet terezia. I dukej sikur këto kangë, kjo potere po e ndiqte mbrapa. Pér dreq iu kujtue edhe ai muhabeti me çobanin e fshatit. Kur ishte ba qerratai?... Fliste tel. — Idriz, mos pre dru të njoma, se këto ruhen. Po të pashë ma, pér ideal do të t'i shkarkoj këtu në rrugë. A more vesht?

Ishte shtri në krah aty, në pazarin e gjasë. Dielli digjte si saç. Bagëtitë ishin shtri në pluhun e mriznin. Fytyrën me mollëza të daluna e ballin e rrudhosun ja kishin mbulue djersët. Kësulën e kishte vu në kokë. Nuk asht shaka... Të ngelet pa u ba

dasma, asht marrja e dynjasë. Cuca asht në belik, bile e ka kalue. Për ate të shkretë e ngrita vocin 2-3 vjet në nafus, se nuk vejshin kunorë. Eh, bela e madhe. Mirë thontenana, rahmet pastë: mos arrifsh t'i martojsht fëmijët, se tamli i nanës do të dalë përhundësh. S'ka pasë faj e shkreta. Kështu asht rropatë kur më ka martue.

— Ec, or mik, e paske nxjerrë mallin. Qënke harxhue shumë! — i foli Selimi, tue e zgjue prej këtyne mendimeve.

Idrizit pō i dridheshin leqet e kambëve e pikë pështymë nuk i kishte mbetë në fyt. Vështronte Selimin që thithte llullën, tue u dhanë me nji dorë mustaqeve të zverdhuna si perçe kali. Ashtu, hie rëndë, i pa lëvizun, Idrizit i dukej si një copë trung i madh. Ai iu drejtue me za të mekun: Or lum miku, ti e din si e kemi hallin. Po hallall miqësia e përhajr na qoftë, se me e dijtë si jemi ba...

— E po dasmë asht kjo — ja ktheu Selimi, tue ja ngulun ata sytë e mëdhenj të zgurdullue e tue pëshpëritë më vete: ç'dhelpën plakë që asht! Ka kiametin e parave e asht ba si nana e drexit. Asht mbledhë si kakruk. Jo or jo, me këto berre të cofta nuk ban dasmë Selimi.


— Kena harxhue shumë — shtoi Idrizi.  
— Mirë, mirë, por zakonet janë zakone.  
Kështu asht kur ze mik malësorin.

\* \* \*

Mbramje. E ndjente veten të dërmuem. Puna e mishit ishte rregullue. Të nesërmen erdhën me marrë sepetet me plaçka. E sa lekë ishin harxhue për to?.. Deri në Tirane kishin shkue me i ba. Me listë në dorë miqtë kontrollonin petkat. Andej nga fundi i letrës ishte shkrue nji emën. Miqtë kërkuen çizmet. E shoqja e Idrizit u ba si e vdekun. Edhe kjo u duhej.

— Për mishin e bamë si e bamë, por ama pa çizme nuk del nuse cuca e Selimit. Tashti s'u kemi faj. — Këto zakone janë zakone vendi. — Miqtë u larguen, Idrizi me gruen filluen me u zanë për të gjetë fajtorin. Ma në fund, Idrizi vrapi në dyqanin e fshatit. Shitësi i tha: «Çizme grash të jashtme s'kemi. Asht verë hala, bre Idriz.

— Moree, i shkreti, — desh të thonte se pa ato nuk ma ep Selimi cucën, por e mbajti. U kthyte në shtëpi. Grueja, mbasi i tregoi dyqanet nëpër fshatrat e luginës, i tha: «Pa çizme mos hajde». Idrizi vari



kambët në gomarin e tij e, nën rrezet e fundit të diellit, vështron te luginën e grykën tutje, thellë, mes maleve ku do të shkonte. Do të kërkonte shitësat nëpër shtëpi. Do t'u lutej. Lëshoi një psherëtimë të zgjatur, nji ofshamje, që i buronte thellë prej gjoksit leshtor e të thatë. Eh, halle dasme.

Ditë e shtunë. Nëpër trollzën e Idrizit kristë një dajrë. Disa zana këndonin në më-

nyrë të çrregullt nji kangë dasme. Pritej të vinte Idrizi. Në rrugën e ngushtë, të mbulueme nga ferrat, u duk nji njeri. Kali ishte la në djersë e avullonte. Nga goja i vareshin shkumë të bardha. Burri kërkoi Idrizin, por meqë nuk ishte ai, dolli e shoqja.

— Selam keni prej Selimit, se dasmë nuk kemi.

— Si ore... nuk kemi dasmë?.. Desh i ra të fikët grues. Me duer lnorte faqet e thata. Desh të lutej, të shante, të mallë-konte, desh të ankohej... Iu errën sytë. Burri i sapoardhur tha: «Cucën Selimi s'e jep po s'erdhën çizmet në shpi. Këto janë zakone malesh e na s'kena si i korisim.

## HIEJA DHE SHKOLLA

Në Bregas kurrë ndonjëherë nuk kishte patur shkollë.

«Bregasi është fshat i largët. Ç'duhet shkolla atje? Fundi i fundit nja tetëdhjetë e ca shtëpi ka. Punë e madhe pse brez pas brezi bregasit lindin, rriten e plaken pa ditur të shkruajnë emrin. Ouaaa! Ç'u dashkan të na bëhen ata? ministra? Le të shohin dhitë e atë dhé që u ka falur perëndia, se, asull-asull, edhe atë tepër e kanë, rjepacakët!». Kështu i qenë përgjigjur ca vite më parë, atje në komune, xha Iljazit, që vdiq me maraz i gjori, nga që s'arriti ta shohë Bregasin, fshatin e vet, me shkollë e fëmijët me libra.

\* \* \*

Skënderi qe mësuesi i parë në këtë fshat. Sa punë iu desh për të hapur shkollën!

Brodhi andej-këndej, e derë më derë, bashkë me këshillin, për të mbledhur nxënësit. Dhe u bënë dyzet e më shumë nxënës. Po jo vetëm shtatë a tetë vjeçarë, po dhjetë e dymbëdhjetëvjeçarë, bile ca edhe katërmbëdhjetë, që dukeshin më të mëdhenj se ai. Sa më tepër shtoheshin, aqë më shumë i gufonte zemra atij. Thoshte me vete: «Do t'i mësoj».

Por ky gjëzim, kjo forcë e madhe, që e kishin pushtuar mësuesin, atij mëngjesi iu errësuan nga një e papritur.

\* \* \*

Nxënësit vinin në shkollë me të zbardhur drita. Këputnin dega lofate, fshinin klasën, se një klasë kishte shkolla, pastaj ca rrinin brenda, ca luanin në sheshin me bar. Çupat e vogla mblidhnin aty afër lule shpatëze, që rriteshin shumë në Brengas, dhe i linin mbi tavolinë. Pastaj të gjithë, çuna e çupa, i delnin përpara mësuesit, që vinte bashkë me Ndrekën.

Shkolla qe bërë gjëzimi i fshatit. Dhe burrat i hapnin punë vetes, po t'u binte rruga andej. Rrinin e vështronin që nga

jashtë, me bërrylat mbështetur në dritare  
dhe habiteshin me Skënderin, se qysh na  
qënkesht kjo punë e shkollës, se si është i  
zoti ky «psusi», që t'i bëka çilimijtë të rrinë  
si në xhami, pa bërë zë. Por ndodhët nga-  
njëherë, që ndonjë fshatar (më tepër bënte-  
vaki që ky të qe plak), hapte derën e shko-  
llës, dhe pasi i jepte një «selam aleqëm»  
Skënderit, me shumë ndërim, zinte vend në  
një bankë andej nga fundi, dhe ja mbër-  
thente sytë në gojë, pa ja ndarë për asnjë  
çast, deri në fund të mësimit. Pastaj ikte,  
ashtu si kishte ardhur, duke përsëritur buzë-  
gaz atë «selam-aleqëm» të tij me dorë në  
zemër.

Kujtimet e tri javëve, që kish mbu-  
shur në Bregas, i silleshin tanimë Skënderit  
në kokë, shumë të turbullta, të errëta, të  
ngatëruara.

\* \* \*

U ngrit nga praku dhe hyri brenda  
në klasë. Ndreka i vajti prapa.

— E Ndrekë, ç'thua? Kush ta ketë bërë  
këtë punë?

Ky, si pa një herë me të shpejtë ato-

eshtra njeriu sipér tavolinës, ktheu kokën nga ana tjetër dhe u përgjegj me zë të ulët:

— Nga ta di unë?

... Kish rastisur, atë mëngjes, që të hynte e para në shkollë njera nga nxënëset, Filja. Sapo kish shkelur te dera e klasës, kish klithur dhe qe mbrapsur me llahtari. Zemra sa s'i kish pushuar. Por edhe nxënësit e tjerë kishin vrapuar nëpër shtëpira me kuje. Kurrë s'kishin parë një gjë të tillë. Pastaj, edhe sikur të mos qe kështu, ç'donin ato eshtra aq të frikshme, të thyera dhe të përlyera me baltë, mbi tavolinë!?

— Të vjen frikë, Ndrekë?

— Jo... por...

— Si?

— Më vjen.

Dolën. Njerën dritare që ishte e hapur, Skënderi nuk e mbylli. Ç'ta mbyllte? Xhamet e saj i gjeti copë-copë...

Arritën buzë përroit të thatë.

— Mos ka dashur të tallet ndonjë?

— Nga ta di unë?

— Ndrekë, përse të mos mblidhemi prapë në shkollë? Ne duhet të vazhdojmë mësimin, apo jo?

— Po.

— Si t'i lajmërojmë nxënësit?

— Vete unë, shtëpi më shtëpi.

Dhe ndërkaq u largua. Skënderi u kthye në shkollë. Afroi karrigën pranë tavolinës, u ul, por sapo mbështeti kokën, e hoqi menjëherë dhe u çua në këmbë. Era e dheut të keq i mbyti hundën. S'dinte ç'të bënte. Nisi të shëtisë nëpër klasë... U ul rishtas në një bankë. Asnjë nxënës nuk po dukej. Mos po priste kot? Por ja, ja behu Ndreka. Fryma i merrej.

— Pse ke vrapuar kështu?

— Se... se...

— Ulu një herë, ulu. I lajmërove nxënesit?

— I lajmërova.

— Po ku janë?

— Nuk duan të vijnë. Thonë që në shkollë ka dalë lugati.

— Ç'lugat? ku ka lugat?!

— Ka, ka zotni.

— Si!?

— Mbrëmë në darkë kishte ardhur këtu Ismaili bashkë me Jonuzin, se kishin harruar librat te cepi i murit. Kur po i knin panë një hie të zezë, që po i afrohej shkollës.

— Hie të zezë!?

— Po, zotni. Ashtu është lugati, si hie e zezë.



Nuk e zgjatën më shumë. Shkuan të dy  
në shtëpi. Te Ndreka rrinte dhe mësuesi.

Pa rënë nata, ky u thotë njerëzve të Ndrekës:

— Sonte më kanë thirrur për darkë te xha Dulja. Nuk do kthehem dot. Mos më prisni!

Pas kësaj shkoi në shkollë. Zuri vend në bankën në cep të klasës, ndenjishtrirazi dhe, si u err, filloi të vëzhgonte.

Iku një orë, dy...

«Ta ketë kuptuar, se mund ta ruajmë, e të mos vijë?»

Skënderi nuk dyshonte se ndonjë nga fshati do të qe...

«Në s'ardhtë në dreq të vejë! Por në erdhi...». Kur sillte këto nëpër mënd, vuri re matanë gardhit të shkollës, një hie të zezë. I hapi sytë shumë. Hieja kapërceu gardhin. Ekte ngadalë... Afrohej te dritarja. Skënderi u fut lehtas poshtë bankës. U përplasën kanatat e dritareve. Pastaj qetësi...

Për një çast, Skënderin e mbërtheu një frikë e madhe. Hieja e zezë u hodh me shpejtësi në dritare dhe që andej brenda në klasë. Bankat kërcitën nën peshën e këmbëve. Skënderi mundohej që edhe frymë të mos merrte. Se ç'u lëshua mbi tavolinë. Diçka u përhap afër dërrasës, disa banka u përbysën pa zhurmë.

«Po vjen këtu!» Skënderit i ngriu gjaku.

— «Po vjen, po vjen!» Hieja e zezë ndaloj. Që nga poshtë i dukej dora, mbështetur një pëllëmbë më tej. Merrte frymë sikur gulçonte.

Ç'të bëj tani? Të ngrihem t'i hidhem? Jo, jo. Sa të madhe e paska dorën! Paska edhe orë! Ja, këmbët! Këpucë paska veshuri! Sikur të kisha një shok, sikur të kisha një armë!... Pse s'po luan që këtu? Ç'pret?... Mos m'i ka ngulur sytë dhe po matet të më ngulë ndonjë thikë?...»

Në këtë çast, hieja e zezë vuri këmbën mbi bankën, nën dritare dhe u hodh jashtë. Skënderi mori frymë me gjithë gjoksin... Ndënji akoma pa lëvizur. Pastaj, ngri ti kokën dhe pa. Hieja e zezë largohej si erë, përtej gardhit.

Për një çast, Skënderit iu duk se qe treguar shumë frikacak. Por ndërroi mendje.

«Jo, veç të kisha qënë i çmëndur, që të lëvizja. Mund të shkoja si qeni në vreshtë... Do t'i tregoj Abazit. Ai është kryetar këshilli. Ka edhe pushkë».

Këto mendime nuk iu ndanë mësuesit, gjersa zbardhi drita. Edhe më parë ai kishte shquar mbi tavolinë një gjë si të rrumbullaktë, veç jo shumë të madhe. Por të themi

të drejtën, kish pasur frikë të shkonte e ta shihte. Se s'do mënd, natë ish, errësirë. Ku ta dije ç'mund të qe? Tani që nata iku, gjithshka dukej qartë.

«Shoh vërtetë, apo më bëjnë sytëë!? Si është e mundur!» Kafka, po ajo kafka e thyer e me dhe, që e kish hedhur në ferra.

S'e mbajti dot veten. Psherëtiti duke e shtrënguar kokën me të dyja duart. Sytë iu mbushën me lot. I fshiu me pëllëmbë. Vajti te burimi. U freskua. U përpoq të merrte një pamje më të qetë. Qe zbehur dhe hequr. U nis për tek Abazi. Asnjë këmbë fëmije s'dukej rrugës. Të gjithë ishin strukur nëpër shtëpirat.

\* \* \*

C'ditë që kishte nisur? Me sa mërzi! Mësuesit i bëhej sikur e kapte dikush në grykë. Një re e madhe, e zezë, po çlodhej mbi majën e malit. Të tjera re endeshin në qiell, si barka peshkatarësh në det. Po ai i shihte me sy tjetër.

Ekte me të shpejtë, donte të arrinte sa më parë te shtëpia e Abazit. Ndjente një dhëmbje në krahëror. Herë-herë nuk kuptonte dhëmbje qe, apo zbrazësirë. Një dorë e thatë, dorë plaku leshtore, sikur i qe fu-

tur thellë në gojë, e përpinqej t'i shkulte mushkëritë.

— Abaz! — i thirri kryetarit të Këshillit, me një zë sa të përmallshëm, aq edhe të shqetësuar, posa ky i doli në prak të portës.

Dhe filloi t'i dridhej buza e poshtme.

— Ç'ka ndodhur?...

Skënderi ja tregoi të gjitha.

— Si, ore? prapë sonte, hë?! — ja ktheu Abazi. Pastaj thithi bishtin e cigares, sa iu përvëluan gishtat, nxori tymin me përtim e, me vështrimin të ngulur në tokë, tha:

— Mos e prish gjakun, se do ta rregullojmë këtë punë. Që mbrëmë po vraç mendjen. Është dora e armikut kjo. U plasi tëmthit, që hapëm edhe ne shkollë, dhe duan të mos na lenë. Pastaj, duan të të bëjnë edhe ty që të trembesh e të ikësh.

— Jo, unë as trëmbem, as iki. Por vetëm ta kapim atë dhe t'i mbledhim nxënësit prapë.

— Të dyja, do t'i bëjmë, të dyja; vetëm ti, ama, mos u mërzit! Se, në fillim, çdo punë e mirë kështu e ka. Do të vijë një ditë, dëgjo mua ti, do t'i kujtosh këto gjëra dhe s'do të të vijë keq që i ke hequr. Ja, ne hoqëm në luftë të zezat e ullirit. Po tani, për

sytë e ballit, kür i zemë me gojë, zemra qysh na bëhet? det. Se ja arritëm ditës. S'i thonë shaka. Është gjë e madhe... Ku ta di unë i shkreti, më merr vesh ti apo s'më merr?

— Po, Abaz, po.

— Ashtu, rrofsh! Tashti, ja ç'të bëjmë.

— Çfarë?

— Hë për hë, hajde të hyjmë brënda në shtëpi, të hamë një përshesh me qu-mësht!

— Jo, jo, dua të kthehem.

— Mos ma prish qejfin, o mësues! Hajde, hajde! Je si në shtëpinë tënde këtu. Për nxënësit mos e vre mëndjen, se e mora unë tani përsipër këtë barrë. I hodhi krahun dhe e la të ecë përpara.

\* \* \*

Abazin e dëgjonin të gjithë në fshat, dhe fjalën dy nuk ja bënin, se çdo gjë që thoshte ai, delte sikur e kishin pleqësuar dhjetë burra. Po atë pasdreke, nuk i shkoi aq mbarë. Në shumë shtëpi i ndodhi e njëjtë gjë: dilte plaka në mes të avllisë e ja priste:

— Marshalla, marshalla! Më trokëllitke

te porta e s'më hyke brënda! Hidh, ore, çapat, se të mora kosoren e të shkurtova këmbët. — Dhe më pas plaste së qeshuri. Po kjo e qeshur, që e priste, nuk e përcillte.

— Jo, jo, të keqen! Veç atë gjë s'e bëj dot. S'kam si e çoj tim nip prapë në shkollë, se më bëhet me ydhër mua korbës, e pastaj më mirë të më bjerë një pikë. Ç'të rroj kot, të shoh ukubetet me sy? Ti, si këshillë që je, gjej një konak tjetër dhe i mblidhni çiliminjtë prapë, se atje, larg qoftë, nuk ju vijnë, mehazallah! Më dëgjo mua, lereni atë vënd, hiquni një sahat e më parë, se e kanë zaptuar shpirtërat e këqinj! Ja, më plaçin këta dy-sy, po s'qe ashtu.

— Mjaft, moj xhexho Salushe, se po flet marrëzira.

— Mirë, o Abaz, mirë, po mos harro, se duhen dëgjuar fjalët e pleqve.

— Ashtu është vërtet, veç këto muhabete, që po bën zotrote, s'janë për t'u thënë. Ç'shpirtëra të këqinj na zë në gojë?

— E, e ç'kérkon ta mbulosh!? Ate llaf e ka marrë dheu, e di i madh e i vogël.

— Moj xho Salushe, rri paç jetën e gjatë, në hallin tënd, e mos fol më kështu, se vetëm na prish punë e s'na ndreq.

— Jo, të keqen, unë e shkreta jam zemërbardhë, qysh ju prishkam punë!

— Ehu! Nuk po e zgjas më. Nesër çojeni Bardhylin në shkollë, atë bëni.

— Hajt, mbeç me shëndet, se ne po ikim. — Dhe vajtën në shtëpinë ku rrinte mësuesi.

Abazi i thotë xha Selimit, të parit të shtëpisë:

— Në s'të mbetet hatëri, o mik, po e mbaj ca ditë mësuesin të flerë andej nga unë. Se, qysh të të them i ziu, më ka hypur në kokë që të nxe ca më shumë në shkollë. M'u dashkérka e uruara. Gjithnjë shkresurina më bien nëpër duar. Dhe shumë sëkëlldi më japid. Pa lëre qysh më kullojnë djersët, kur i këndoja, si në mes të gushtit. Se llafet me zahmet të madh i lidh, dhe ato të shkreta shkronja i zë një e nga një. Kështu de, o xha Selim, po takem ca kohë afër mësuesin, ashtu pranë oxhakut; sikur fare gdhë të jem, do të mësoj ndopak. Dhe mbasë do ta kem më kolaj më ato shkresurinat.

— Shumë gjë e mirë të paska vajtur nér miend — ja ktheu xha Selimi. — Pso, më paç uratën, pso, se ke vakt akoma. Po ne pleqtë ç'të bëjmë që e hëngrëm kullotën.

Sytë në ballë i kemi dhe qorra që qorra jemi. Eh, kjo dyniaja me rrota!

Si dualën nga shtëpia e xha Selimit, Abazi i kthehet Skënderit:

— Ti mos kujto shoku mësues, që i këputa një gënjeshtër plakut, se vallahi, si të kapërcejmë këtë bela, ashtu vërtet do ta bëjmë.

— Me gjithë qejf, Abaz.

— E, e, kështu thua ti, po ta dish veç, që nuk do ta kesh aq të lehtë, sa e ke me çiliminjtë. Se kjo koka, që kam unë, është sa një karroqe. Kam frikë se mos do të të duhet të zbrazësh fare tënden, që të mbushësh timen.

Kur arriten te rrapi i djegur, Abazi, pasi shikoi rreth e rreth e u sigurua se s'kish njeri, i tha Skënderit:

— Këtë do ta mbash ti. — Dhe i tregoi një revole. — Kij kujdes. Ëshë plot. Mba vesh këtu, si shtihet me të... Më parë kjo siguresë ulet poshtë me gishtin e madh, pastaj tërhiqet këmbëza dhe... Kuptove?

— Kuptova.

— Kaq, na, merre!

Skënderit i ndritën sytë. E mori me shumë gëzim.

Pastaj Abazi tha:

— Pa të dhënë urdhër unë, të mos e zbrazësh. Këtu me urdhëra është puna. Ti mos u zemëro!

— Jo, nuk zemërohem.

— Ashtu de!

Një copë rrugë e bënë pa shkëmbyer fjalë.

\* \* \*

Pak e nga pak u bë natë. Hynë në shkollë. Skënderi do të rrinte afër tryezës te dritarja karshi derës. Abazi atje, ku një natë më parë pati qëndruar Skënderi.

...I pari, pasi nguli këmbë Abazi, ra të flinte Skënderi, mbi dy banka të afruara pranë njera tjetrës. Abazi vështronte jashtë dritares, andej nga ana e gardhit. Në mes dy këmbëve kishte vënë pushkën, të dyja duart përmbi tytën e pushkës dhe njérën faqe përmbi duart. Nuk po mbyllte dot sy. Asnjë lodhje s'ndjente. Vetëm mendonte:

«Ah, ç'm'u pik për një duhan! M'u çà hunda fare. Sikur ta pi një? Bah! Edhe kjo duhet këtu».

Abazi, sikurse e lanë të dy, do ta zgjuante Skënderin kur të këndonin gjelat e parë dhe pastaj do të flinte vetë. Dhe ja, gjelat e

parë kënduan. Kryetari i këshillit u ngrit nga vendi dhe, duke ecur me çape të lehta, gjithmonë pa e ndarë vështrimin nga gardhi, iu afroa mësuesit. Qëndroi më këmbë përpara tij. Mezi ja shquante fytyrën në errësirë. Ai, mësuesi, bënte gjumë të qetë me krahun e majtë të varur poshtë. Abazit iu dhimbsh shumë. Deshi t'ja kalonte mbi ballë pëllëmbën e dorës me kallo të trasha e të ashpër, por ndryshoi mëndje, se druhesh mos e zgjonte. U kthyesh prapë, po ashtu me çape të lehta, gjithmonë e pa e ndarë vështrimin nga gardhi...

Kënduan gjelat e dytë. Errësira po lëkundej. U muarr vesh: hieja e zezë nuk do të vinte.

Vetëm kur ra drita mirë, kur as kishe ç'të ruaje e nga se të ruheshe, Abazi ndezi një cigare.

E zgjoi Skënderin, pasi e çoi cigaren në gjysmë.

— Paska zbardhur!? — pyeti ky me habi.

\* \* \*

Abazi dhe Skënderi vazhdonin të tyren. Natën e kalonin në shkollë duke ruajtur.

Abazi qe si gjithnjë i qetë, kurse Skënderi jo.

— O Abaz, më duket se i ka rënë era.  
— Prit, prit! Akoma s'dihet.  
— Si s'dihet. Kaluan kaq ditë.  
— S'ka gjë. Do të presim. Ta kapim lepurin me qerre. Sa marifete kanë këto punë. Të liqtë janë si gjarpëri. Nuk i tregojnë këmbët.

— Se mos po mendojnë që nuk u doli gjë dhe i venë kapakun me kaq?

— Jo, jo. Mbase s'po ndihen, që të ftohet pak muhabeti.

... Skënderi qe dobësuar e zverdhur pak, po sytë i qenë thelluar shumë. Lëkura rrëth tyre i qe bërë edhe më e hollë dhe i kish marrë një ngjyrë mavi. Kur fliste e qeshte me nxënësit, vështrimi i dukej më i ëmbël, më i dhëmshur, më pak i gjallë, i përvuajtshëm, e ai vetë ngjante më i vogël, tamam 14 vjeç.

Ditë të tjera ikën.

Mësuesi e kishte humbur besimin, kurse Abazi, jo. Ai ecte i qetë, me krahun e rëndë mbi shpatullat e vogla të mësuesit, dhe ndjente një forcë të çuditshme, që e tërhiqte drejt shkollës. Mollëzat e tij pa mish, faqet e hequra, vetullat e trasha dhe të zeza,

balli si tokë brazda-brazda, të gjitha ngjanin si të skalitura me daltë. Sytë e tij, kur të shikonin, të mbërthenin si shtiza.

\* \* \*

...Ishte mesi i natës. Hieja u duk matanë gardhit. Po vjen, po vjen!... Erdhi! — tha nëpër dhëmbë mësuesi dhe filloi të dridhej nga gëzimi. Lëvizte duart, zinte gojën, kafshonte gishtat, shqyente sytë... Nxori revolen nga xhepi. I bëhej të thërriste, sa të dëgjonte i gjithë fshati:

— Erdhi! Erdhi! Ja tek është, ja, po afrohet! Abazi rrinte gati me pushkën shtrënguar fort.

Heshtje... Vetëm një cinxër e prishi qetësinë me férshëllimin e tij.

Dritarja u hap lehtazi. Hieja e zezë kërceu mbi dritare, mbi banka. Bankat kérçiten.

— Duart lart! — thirri Abazi.

— Mos luaj! — thirri Skënderi.

Duart e hies u ngritën lart. Se ç'iu rrëzua përdhe me zhurmë.

— Një hap po bëre, të shkoi koka në hava! — vazhdoi Abazi me grykë e me

dhëmbë. Luajti shulin e pushkës dhe e çoi fishekun në gojë. Me gishtin në këmbëz hodi një hap përpara.

— Zbrit nga bankat!

Hieja e zezë zbriti me këmbë të dredhura dhe, duke mbajtur duart lart.

— Afrohu te muri.

Hieja e zezë iu afrua murit.

— Edhe më, po të them!

Hieja e zezë iu afrua edhe më.

— Ngjitu, ngjitu me murin!

Hieja e zezë u ngjit me murin.

— Hapi këmbët, qen bir qeni!... Hapi akoma, se t'i zbraza trutë!... Ashtu! Mos luaj tan!

— Po luajte, kaq e pate, — ja priti më-suesi. Abazi u mbraps te ky. I la pushkën, i mori revolen. Me atë në dorë i vajti hies së zezë.

— Jam dorëzuar, mos më vrisni!

— Mjaft! Ashtu më rri, në s'të ka ardhur vdekja! — Njerën këmbë dhe dorën e djathtë me revolen, Abazi i mbante më prapa. E kontrolloi në njërin xhep të pantallonave, s'i gjeti gjë. E kontrolloi në tjetrin, i nxori një revole, e futi në xhepin e vet. Ja kaloi pastaj dorën në brez. I mori thikën. Bëri dy hapa më këtej.

— Ç'ke tjetër? Folë!

— S'kam gjë.

— Mirë. Në pate, dëm kokës do t'i bësh.

Uli duart tani!

Hieja e zezë uli duart.

— Bëni kryq pas kurrizit, po të them!

Hieja e zezë i bëri kryq pas kurrizit.

Abazi e lidhi.

— Tashti merr një valle, po deshe.

Hieja e zezë mblofdhi këmbët, u kthye ballë për ballë dhe gjunjët nuk e mbajtën. U ul ngadalë.

Në këtë kohë, nga jashtë, u dëgjua një zë i trashë:

— Ej, ju aty brënda! Lëshoni armët dhe dilni, së jeni të rrethuar!

Hieja e zezë filloi të lëvizte. Abazi mbështeti tytën e pushkës mbi kokën e hies së zezë.

— Ti nepërkë, mos hidh vicka! Dëgjon? Se plumbat në vesh t'i zbraz!

— Si s'më ra ndër mend, dreqi ta hajë, — u hëngër Abazi me vete, — se ky edepsës mund të kishte edhe zagarë të tjerë nga prapa.

U duhej kthyer përgjigja atyre, që dhanë urdhërin.

— Armët në i deshët, hajdeni të na

i merrni! Zakon s'e kemi t'i dorëzojmë vetë.

— Kush je ti, që na flet?

— Hyni këtu të më shihni?

— O po kush je, të marrtë lumi!

— Ju fola një herë. Llafet e shumta ua kemi lënë grave në shtëpi.

— Mos je Abazi, kryetari i këshillit?

— Ai vetë jam. Hajde të ta shoh surratin!

— Zbutu, o t'u mbylltë dera, se jemi forcat e sigurimit. Si s'po ma njeh zënë! Jam Elmaz Lapi. Kemi kaq orë që na ranë këmbët pas një... Mos ma ke aty firaunin?

— Siurdhëron, këtu e kam. Merak mos u bën! Shëndoshë e mirë është. Bujrum ta dredhim nga një duhan!

\* \* \*

Kaçatori i fshatit, Sinani, i zuri shtëpitë me radhë.

— O Sadik!... Sadik!...

— Lepe!

— Bën ç'të bësh, e merri të gjithë robt' e shtëpisë e çapni te sheshi i shkollës, se ka një mbledhje.

— Hair ishalla! Ç'është kjo mbledhje që në pikë të sabahut?

— Nuk e di. Kështu më tha Abazi, kështu të them. Pa vajtur sahati dy e gjysmë allaturka, i madh e i vogël atje të mblichen.

Ca e nga ca, i gjithë fshati po derdhej në sheshin e shkollës.

Dera e shkollës ishte me kyç. Nxënësit bridhnin lart e poshtë. Kryetari i këshillit akoma s'po dukej.

Në atë çast Skënderi futi çelësin në dry dhe dera e shkollës u hap. Që andej doli kryetari i këshillit me pushkën hedhur krahut.

— Shiko, shiko paskësh qënë i myllur brënda! — i pëshpëriti në vesh xha Braushi xha Telos, duke qeshur me zë të ngjirur.

Pastaj Abazi, si u hodhi njerëzve një vështrim me kokë, tha:

— Ju, gratë, qasuni ca! Çiliminjtë le të dalin në këtë anë... Ashtu, de!... Dëgjoni tani! A ua merr mëndja përse ju kemi mbledhur?

— Jo! — u ndjenë disa zëra.

Mirë. Që të merrni vesh... aty nja tri javë e ca të shkuara, në shkollë na pat ardhur një lugat.

— E, të keqen pat ardhur, — foli si me vete xho Salushja, duke tundur kokën

andej, tek qe, në mes të grave. Ma dëgjove që ma dëgjove fjalën, or bir. — Pastaj iu kthye shoqeve: prit kur të thotë tashtithi, që do ta çkulin shkollën që këtej.

— . . . Kështu, na pat ardhur një lugat... pooo. . . dhe ai qerrata na prishi shumë punë, apo jo?....

— Ruana zot! — pëshpëriste xho Salushja.

— Ne kujtuam — vazhdoi Abazi, — se nuk do të na binte havale, po ai qënkeshe fare harbut. Prapë na erdhi mbrëmë, edep-sëzi.

— Në gurtë e në drutë! — folën gratë përzier.

— Po besoka, o Telo, për jallanë po besoka edhe kryetari në lugatin, — tundte xha Braushi xha Telon.

— Ju çiliminjtë mos u trëmbni, se lugati, që shkeli prapë në shkollën tuaj, kurrë më nuk do të shkelë.

— E ore, e, ku bëhet dot zap ai? — tha xha Telua.

— Bëhet s'bëhet është punë tjetër, — ja priti Abazi — unë vetëm këtë di t'ju them, që kësaj radhe s'i eci të shkretit, se e ka pësuar si cjapi te kasapi. E kemi mbërthyer dhe e kemi këtu brënda.

— Qyqja — ja bënë gratë.

Bardhyli u drodh! Ismaili dhe Jonuzi shikuani njëri tjetrin me sy të shqyer. Ndrekë siker hidhej përpjetë.

— Hiihihihi... hiihihihi... — qeshi plaku si gjithnjë, me grykë e me zë të ngjirur. Pastaj iu kthyte xha Telos.

— Unë vë kokën në satër, në s'ju ka ikur. Ku lidhet ai, ore?! Fjalë është kjo! Fësht ja bën dhe të lë pendët. Hajde ta gjesh pastaj.

Xha Braushi iu kthyte prapë Abazit:

— Mirë, de, mirë; po ta keni lidhur, na e nxirrni një herë t'ja shohim çehrenë!

— Ç'çehre kërkon të shohësh, or lumëmadh, — ja priti xha Telua.

— Jo, këtu e ka mirë, — tha Abazi, — ne do t'ua tregojmë pa tjetër, se kot nuk ju thirrëm... po unë kam qejf, qysh e shëmbëllen xha Braushi lugatin.

— E si do ta shëmbëllej, o t'u shtoftë ymri? ja, ashtu si plënc, që ikën, duke këcyer: pllup, këtu, pllup aty.

Abazi dhe Skënderi ja plasën së qeshurës.

— Po ti ke parë ndonjëherë lugat?

Mësuesi rrinte në mes të nxënësve, afër Ndrekës. Nga brënda shkollës u dëgjua:

— Hë de, luaj! — dhe sakaq në derë  
u duk hieja e zezë me duar të lidhura. Të  
gjithë u ngritën në këmbë.

— Qenka rob! — bërtiti xha Braushi.

— Hihihishi...

Pas hies së zezë dolën Elmas Lapi, Ve-  
sel Halimi, Servet Tusha.

Burrat sa e panë, thanë:

— C'e paska atë dreq mjekër!?

— Qenka alamet zdapi!

— Një tufë dhënë i bëka ajo palltoja  
prej meshine.

Gratë sa e panë, thanë:

— Uaaa!...

— Të kallka datën, moj korbë!

Shoq pastë veten!

Në shesh bëhej zhurmë e madhe.

— Ja, ky është lugati — tha Abazi.

## KORROSAKU

Llukë Sqepari, kur u rrit e vuri brisk  
në faqe, mendoi se ku të punonte; së fundi  
e bëri mëndjen top e i tha të jatit:

— Nuk shkoj as hamall në Durrës, as  
bari në tufat e zengjinëve.

Djali bëri çikës me këmje e gjuante në-  
për këneta. Pastaj, kur e mësoi mirë mje-  
shtërinë e peshkatarit, u fut si punëtor ko-  
rrosak në gjolin që kish marrë iktizam Peço  
Poçari, njeri me dhëmbë në qytet e me pa-  
suri në fshat.

Bashkë me gjolin e Korrnicës e pyllin e  
Poros, Peço Poçari kishte marrë iktizam  
gjithë ç'mbante meraja verore, prej Boçove  
deri në Apolloni. Në këto vende djerrë,  
gjysmë të shkreta, ku nuk shkel këmba e  
njeriut, zoti Peço nxirrte fitime. Për këtë  
çiflik të papunuar, që ish i hapur sa s'ta zin-

te syri, zotnia paguante pak. Siç dukej, një-rëzit e qeverisë nuk e dinin se sa pare nxirr-te peshku i verës e i dimrit në gjolin e Korrnicës, s'e dinin se ç'të ardhura kishte pylli i Povelçës e i Poros. Atyre as që do t'u ketë shkuanar në mëndje se, edhe në kënetën e kripur të Laçanit, Peçua nxirrte fitime me majë.

Vërtet, me ujë të qelbur rrinte këneta e Laçanit deri në gusht, po kur vapa e verës arrinte kulmin, ajo thahej e nga ujët e saj pocaqi dilte kripë e bardhë.

Pa një bekçi të zotin nuk bënte dot Peçua. Kërkoi e kërkoi edhe e gjeti Latif Laron, kushërinë e Ali Mustaques, që ishte qahajai i Qemal bëut. Latif Larua qe trim, i këmbëzës, por si njeri i rritur në malësi, s'kish mësuar as not, as të ngiste lundrën.

— Po hë, se ja del në krye Latifi — kish thënë Peçua, — pse do t'i gjej manxerin unë.

Kënetën e Laçanit, që nga Povelça në Hoxharë, të gjithë e truajnë, se ajo është foleja e shejtanëve dhe e laçove. Këtë gjë e dinin dhe shënjtorët lart, prandaj e kanë rrethuar këtë vend të mallëkuar, me kisha: nga perëndimi Shëne-Premtja, nga lindja Shën-Maria dhe në të dyja anët e tjera Shën-Kolli e Shën-Pjetri.

Po sado vend i truajtur prej Perëndisë e njeriut, Laçani u jepte një pasuri myze-qarëve, në muajt e verës, kripën e bardhë si ajkë mbi llogace.

Atë vit, kur erdhi bekçi Latif Larua, u bë kripa pa masë. Gëzonin soparakët e gjithë fshatarët për rreth.

Barinjtë, që kullosin bagëtinë nga çolet përzier me jamruk, e shikonin të parët bardhësinë e kripës.

— U bë kripa, thanë pelarët në grëmezt e egra.

— U bë kripa, thanë, më tëhu kënetës, loparët e çolet.

— U bë kripa, thanë, më tëhu akoma, dhenaqët te çairet djerrë.

— U bë kripa, thanë pularët përmes marinave, anës kënetës.

Dhe lajmi, gojë më gojë, shkonte deri brënda në fshat. Fjala se ishte bërë kripa, mbushte me gëzim zemrat e fshatarëve, sikur kokrrat e kripës të qenë kokrra drithi, kokrra floriri.

Ishte ditë e nxehjtë vere dhe fshatarët po niseshin për të mbledhur kripë me dorë në shportë dhe druajtje në zemër. Po ecnin soparakët e shkretë si varfanjakë, me këmbë të zbathura e të grisura nga thereckat, të

shpuara nga zhukat e drizat. Ata iknin me nxitim mbi tokën shëllirë plasra-plasra, për të arritur sa më shpejt te kripa, që zbar-dhonte si pëlhirë në kënetë.

Në anën tjetër, nga fundi i kënetës së Laçanit, Latif Larua përgjonte mbi një bës ranor në formë mullari. Kur ndezi çibukun, sytë i vajtën përpara, shumë thellë, nga cepi i shteruar i kënetës së Laçanit. I bëhej se atje në cepin e Sopit, afër Boçovës, kishte hie të holla, që zgjateshin nga avujt e vapës.

— Me siguri, njerëz që mbledhin kripë...

Dhe sa më shumë që ky mendim ja pëshkonte trutë, aq më tepër i qeshë buza, aq më tepër i hapte sytë. Një gëzim i turbulluar po e ngacmonte përbrenda dhe e bënte të thithë më shumë çibukun. Përmes reve të vogla të tymit të duhanit, bekciu përfytyronte me kënaqësi, sikur kish gjetur në kripë fshatarët, i kish zënë me presh në dorë, ua kish hedhur në qafë thasët e mbushur dhe i kish vënë përpara, si komarë të ngarkuar, pér në komune.

Atje do t'ua jepte në dorëzim xhandarëve. Pa do të vinte kryetari i komunes! Pa le kur t'ua vinin dy këmbët në një opingë atyre fshatarëve hajdutë. Emri i Latifit do të

bëhej i nderuar. Të gjithë do të flisnin për trimërinë e tij. E ja, kur të shihje që ta thërrisinin në qytet e t'i thoshnin:

«Për ty, o Latif Larua, kemi nevojë, s'do ta lëmë trimërinë tënde të humbasë andej nëpër marinat e Laçanit. Ty do të të bëjmë xhandar».

Teksa mendonte kështu me vete, dëshira po i shtohej për të vajtur deri në atë pjesë të kënetës, ku qe bërë kripa.

Llukë Sqepari në lumin e Korrnicës këndonte mbi shtratin e peshkimit dhe ngrinte herë pas here çikën. Latif Larua zbriti nga bësi dhe iu drejtua peshkatarit, që merrte këngë duke fishkellyer. Pasi e takoi në breg, e pyeti për lundrën dhe në se dinte ta ngiste mirë. Kur po zgjidhte lundrën, Lluka i tha bekciut:

— Ku ke për të vajtur?

— Ja, — foli Latifi, — te ajo anë e kënetës, ku është bërë kripa.

Peshkatari bëri sikur u mendua:

— Si thua, do ta çosh lundrën deri atje?

— Po do mundohemi — u dëgjua Lluka.

— Hë, se do të ta shpërblej; s'do të ta

marr gjysmën e peshkut, që i takon zotnisë,  
si pjesë nga malli i tij.

— Me gjithë mënd?

— Po, more djalë, s'e ha fjalën unë,  
më thonë Latif Larua mua. Thashë s'e dua  
dhe mbaroi.

— Një minutë, pritni sa të hedh trastën  
me peshk në krahë e ta lidh mirë — tha  
Llukë Sqepari.

Të dy u nisën me lundër, përmes kë-  
netës së Laçanit, për në cepin e Boçovës,  
ku dukej kripa si petë dëbore. Lundra, si  
koritë e gjërë, ecte pa zë në ujin e rëndë:  
Qetësinë e natës e prishnin bretkosat, që  
kuaknin dhe çakjenjtë që angullinin pyllit.

Në fillim, lundra rrëshqiste pa frikë,  
po kur u futën në thellësi, ajo sikur zuri të  
voziste me droje. Bekciu u tremb pak; për  
t'u siguruar një çikë e pyeti djaloshin:

— Ke ngarë herë tjetër lundër ti, çun?

— Po si s'kam ngarë. Dhe në dimër,  
bile dhe në Korrnicë kam lundruar.

— Po si të quajnë ty?

Djaloshi bëri sikur s'dëgjoi e i dha  
lundrës një fuqi me koll dhe e bëri që të  
dridhet pak.

— Ngadalë, more kokëshkretë, desh na  
vithise!

— Mos ki frikë, Latif aga — thoshte peshkatari.

— Si të quajnë ty? — përsëriti bekçi.

— Eh! çfarë the? — thoshte djali.

— Si të quajnë, more i paudhë?

— Aha, si më quajnë, më quajnë Krrrosak, Korrosak Lundra.

Kur arritën në mes të udhës, Lluka pyeti bekçiu:

— Pse do të shkosh në Boçovë, zotrote?

— Se ashtu duhet. Nuk di ti se ç'ndodh kur bëhet kripa! Fshatarët janë njerëz të zjosur dhe shkojnë e mbledhin si të babëzitur, pa pyetur në ka zot ky mall, apo jo.

— Nuk e besoj, Latif aga.

— Nuk e beson ti, po kjo është e vërtetë. Janë mësuar me vjetet e kaluar ata maskarenj. Atëhere s'kish bekçi për të qënnë. Po tashti do t'ua rregulloj unë samarin.

— Njerëzit e këtyre anëve kanë namuz, rrojnë me nder, nuk vjedhin, Latif aga.

— E, more i paudhë, edhe ti vetë je nga këta, po s'ma hedh dot mua, jo. Fshatarët janë dreqër me brirë.

— Pse e kujton dreqin? Apo pse po udhëtojmë te shtëpia e djajve.

Bekçi heshti. Lundërtari pyeti:

— A e ke parë ndonjëherë djallin, zotrote, kur del për t'u larë?

— Jo. Pse, ti e ke parë? — foli si me çudi Latifi.

— Si s'e kam parë! Për çdo javë unë shoh dreqër. Këtu është vendi i largneshit. Pse i thonë Laçan?

— Ashtu?!

— Pse thashë të mos truaje?

— E, po më shpëtoi!

— Që ta marrësh vesh zotrote... aqë duan laçot këtu në mes të ujtit. Ata dhe pa thirrur e pa truar vijnë vetë. Nuk e dini ju, Latif aga, se djajtë e kënëtës nuk flenë natën? Apo s'po udhëtojmë mbi shpinën e tyre?

— Pa më thuaj, si e pe ti atë djallin, që t'u çfaq?

— Cilin? se unë të thashë, s'kam parë një djall. Ohu... sa shejtanër më janë çfaqur mua!

— Po si de, si të çfaqen?!

— Si të qëllojë. Ja, para ca kohe udhëtoja një herë natën, tamam në këtë vend dhe kur do ti të më fanepset një hije, pastaj si njeri me brirë dhe me bisht? unë e shava (se shejtani duhet sharë gjithnjë). Ai ndërrroi ftyrë dhe m'u bë si gomar, pastaj

si pulisht, dhe më pastaj kërriç i vogël fare e me veshë të gjatë... aman, o Zot, sa u tremba! Pastaj, u kthye si vajzë e deshi të më joshte, po unë s'pyesja, e ngisja lundrën fort, fort, dhe dola më së fundi.

— A u trëmbe pak?

— Unë të trëmbem!? Nga shejtani!?. . . S'e tha Zoti.

— Çudi jini ju peshkatarët! Si s'trëmbeni fare nga dreqi!?

Llukë Sqepari e pyeti pastaj bekciun:

— Ç'do t'u bëni atyre, që do të gjeni duke mbledhur kripë?

— Do t'i bëj që të venë mënd.

Lundra rrëshqiste mbi ujë, në afro një metër e gjysmë thellësi. Korrosaku mendonte me vete: «Ah, qen i biri qenit! shkon t'u bjerë më qafë njerëzve të pafaj. Kush e di, atje mund të jenë edhe vëllezërit e mi e ky qerrata vete e u a sjell në majë të hundës... Po jo, jo, s'do ta lë të thatë». Kur korrosaku po mendonte kështu, duke lëvizur kollin, bekciu i tha:

— More, ç'më shohin ashtu sytë!?

— Nga? — i foli fort lundërtari.

— E, mo, po ja, përpara.

— Shët! — ja bëri Lluka, — akoma s'e kupton? Është vetë qoftëlargu.

Korrosaku e ndërroi drejtimin e lundrës, andej nga ishte një marinë, një metër e ca e lartë mbi ujë, që ngjante si hije e frikshme prej djalli.

— Qënke këmbë ters, Latif aga... Ja, tjetri shejtan! Si do të bëjmë?


Bekciut, që vërtet s'dinte not dhe as lundër të ngiste, filluan t'i dridhen gjunjët. Harroi dhe èndërrën për t'u bërë xhandar. Nja dy degë marine, të dala anash, i bë-heshin veshë prej të mallëkuari dhe dy të tjera i dukeshin krahë. Lluka bëri që lundra të binte mbi degët e marinës, pastaj me zë si klithmë, bërtiti:

— Na rrëmbeu shejtani! Shpëto kokën, Latif aga!

Korrosaku po notonte me të mbathura, siç që me trastën me peshk hedhur krahëve, kurse bekciu rrinte i mbajtur në të dyja anët e koritës. Lundra po lëpinte ujë, kollin e kish flakur Lluka tutje. Latif Larua zbriti në ujë, pushkën e mbante në duar. Fishekët iu qullën dhe manxeri i mori të lagur, qysh me çapat e para që bënte gjithë tronditje.

— Obobo, Koorrosak! Obobo!

Lluka bërtiste nga ana e tij. — E pe ç'na bëri shejtani?! E pe?



— E pashë, e pashë, por s'po shoh si do të dalim.

— Latif aga, shejtani ka frikë nga zjarrri, prandaj shtjerë me dyfek.

— Do të tallesh!? S'i shikon fishekët dhe pushkën si janë njomur nga ujët!?

— Provoje, provoje, — thoshte Lluka dhe mezi e mbante të qeshurit.

Latif Larua, me ato mënd, krodhi duart në ujë, hoqi një vezme me fishekë në brez dhe e vuri në grykën e pushkës. Mori të shtinte dhe ajo nuk zbrazej. Kur pushka nuk po shkrepej, e pa të plotë fitoren Korrosaku.

— Hajde pas meje, Latif aga, mos ki frikë, tutje është më cekët; po ruhu nga shejtanët. Lluka ecte duke notuar e s'e hante meraku për lundrën, e njihte vendin me pëllëmbë. Lundërtari ecte me not, pa droje, bekciu i shkonte prapa, më këmbë, gjysmë i vdekur, duke bërtitur me zë lutës e pa turp.

— Aman, Korrosak, mos ikë shumë larg meje.

Po Llukë Sqepari e bëri të tijën. Si u largua në errësirën e natës, ai i foli bekciut:

— Nuk më quajnë Korrosak, jo, nuk më quajnë Korrosak.

Në pellgun e cekët Lluka ikte më këmbë. Ai ecte shpejt. E pse të mos nxitonë!? Apo do t'i rëndonin rrrobat? Me nder, vetëm në të mbathurat qe. Me të arritur te vendi ku njerëzit mblidhnin kripë, gjeti fshatarët e tij. U kallëzoi ç'i kish ndodhur me bekçinë e u largua bashkë me ta për në sop.

## BUALLI I KËNETËS

I pari që «e pa» atë ishte Petro Zariku, ndihmës-traktorist në kantierin e bonifikimit. Themi «e pa», sepse as vetë Petrua nuk dinte të thoshte se çfarë pa, megjithse betohej se «diçka pa».

Atë mbrëmje nëndori, ai kthehej si zakonisht për të kaluar natën në shtëpinë e vet. Ishte vonë, gati më të ngrysur, kur u nis nga kantieri dhe po nxitonë të mos e zinte nata rrugës, jo për gjë tjetër, por sepse nuk donte të gjendej buzë kënetës natën. Sidomos i druhej asaj pjese ku këneta ishte e mbuluar me kallamishte. Ruga nga do të kalonte gjarpëronte e futej thellë në këto kallamishte, që natën të këllisnin datën me fëshfërimën e tyre. Le që ai edhe ditën druhej të kalonte përmes tyre vetëm. Kjo pjesë

e kënetës s'dihej pse lidhej në kujtesën e tij me legjendat e ngjarjet e tmershme, që kish-te dëgjuar kur ishte fëmijë.

Por megjithse nxitoi, atë e zuri nata tamam afër kallamishteve.

Atë pasdrekë kishte rënë shi dhe qielli ishte ende i mbuluar me re të zeza, që lë-viznin me shpejtësi, duke fshehur e duke nxjerrë një drapër hëne që po perëndonte. Nga këneta vinte një erë e keqe barishtesh të kalbëzuara dhe dëgjoheshin gjithfarë zë-rash e britmash të shpendëve të ujit. Çfarë jehone të çuditshme që nxirrnin këto zëra! Çukitjet e vazhdueshme të rosave të egra, klithmat e rosakëve, vikamat e piskave e të begaçinave, gagarisjet e patave dhe zérat e tjera të shpezëve të kënetës përziheshin njeri me tjetrin dhe dukej sikur shoqëronin fërshëllimën e erës së detit dhe fëshfëritjen e pandërprerë të kallamishteve.

Petro Zariku, për t'i dhënë zemër vete, filloi të këndojet. Këndonte, por mendjen e kishte te fëmijët që e prisnin rrëth vatrës, te gruaja e bëshme e topolake dhe sikur ndjente afshin e nxeh të të zjarrit të oxhakut, që e priste.

Befas një klithmë çau ajrin, kaqë afër, sa atij filluan t'i gjëmojnë veshët. Ishte një

britmë e hollë, si e thirrur e ndonjë fëmije. Ai qëndroi në vend, mbajti frymën dhe vuri dorën në zemër, sikur ta ndalonte që të mos i shqitej nga krahërori. Por britma u përsërit prapë në ajr, disa hapa larg tij dhe ai shkru e vuri buzën në gaz, kur e kuptoi se ishte trembur kot, nga një begacinë.

Tashti vazhdoi rrugën duke u futur mes për mes kallamishteve, vendit më të drojtur. Nuk këndonte më. Ndoshta pushoi këngën që të mos shqetësonte «qeniet e padukshme», xhindet e shtrigat, që, në imagjinatën e tij, strehoheshin në këtë vend të llahtarshëm. Kështu, në heshtje, dëgjohezin vetëm çapat e tij dhe herë pas here fëshfërimat e kallameve dhe britmat e zogjive. Rënkinin që erdhi thellë nga këneta ai as nuk e dëgjoi në fillim, por pastaj mbajti vesh mirë, bile qëndroi në vend. Po. Nga këneta vinte një rënkim i thellë, si grahmat e një njeriu që jep shpirt. Pastaj u dëgjua përplasja me zhurmë e një trupi të rëndë në ujë dhe një fëshfërimë më e fortë e kallamave. Për një çast mendoi se dikush do të ketë ngecur në kënetë dhe u mat të thërriste, por pastaj u kujtua se këto rënkimë nuk dilnin nga fytì i njeriut. Atij iu dukën

kaqë të çuditshme, kaqë të huaja, sikur të vinin nga një botë tjetër! Dhe padashur zemra iu tkurr dhe filloi ta pushtojë një frikë e paspieguar. Pikërisht në këtë çast, një ulurimë e llahtarshme çau ajrin e qelbur të kënetës dhe ai «pa» kallamat të përkulen gati për të puthur tokën, dhe «ndjeu» një afsh të nxehjtë zjarr, që iu përplas në fytyrë. Mbeti i ngrirë në vend: donte të bërtiste por nuk bërtiste dot, donte të vraponte por nuk lëvizte dot. Zemra sa nuk i pushoi dhe u përplas në tokë, sikur e shtyu njeri pa pandehur. I llahtarisur vështronë kallamishtet dhe iu duk sikur «një gjë e zezë», si një re vigane, po ngrihej nga këneta dhe po i afrohej ta përpinte. U mblohd kruspull ashtu, shtrirë, siç ishte në baltë. Pastaj, as ai nuk e kuptoi, se si e mori veten, eci një copë herë këmbadoras, u ngrit në këmbë, u rrëzua prapë, u ngrit dhe filloi të vraponte, duke u penguar nëpër plisa e shkurre dhe duke u rrëzuar herë pas here. Nuk ndaloj, por u përplas te dera e shtëpisë së vet dhe ra shakull, pa ndjenja, te praku i saj.

Kur erdhi në vete pa të ëmën, që po i fërkonte damarët, dhe gruan e fëmijët e trembur për rreth, që po vështronin të shqetësuar.

— Ujë, ujë, më jepni ujë! — tha duke marrë frymë me zor.

E gëlltiti ujin e gotës, duke e derdhur shumicën në krahëror.

— Ç'pate, bir' i nënës?

Sa për t'i dhënë asaj përgjigje, nga këneta u dëgjua prapë ulurima.

— E dëgjon? — e dëgjon? — klithi.

— Po, more bir, kemi qëkuri që po e dëgjojmë dhe nuk po e kuptojmë ç'është — tha ajo.

— Ah, ta dini, si kam shpëtuar! O Zot, si kam shpëtuar! — bërtiti Petrua, duke vështruar me sy të zgurdulluar diku në tavan, dhe pa shtuar asnje fjalë përnjëherësh mbuloi kryet me jorgan.

Atë britmë e dëgjuan të gjithë fshatarët, që banojnë rreth kënetës. Edhe ata nuk e spieguan dot këtë klithmë të çuditshme. Kalamajtë, duke vështruar prindërit të frikësuar, u rrasën fort pranë njeri tjetrit, në të shtruarat. Dikush, për t'i dhënë zemër vetes e të tjerëve, u mundua ta kalojë lehtë, duke thënë se duhet të jetë ndonjë buall i ngetur në baltë, por prap as ai vetë nuk ishte i bindur. Pleqtë ranë në mendime dhe nuk e thanë dot fjalën e tyre, sepse kishin frikë mos i tallnin të rinjtë, por edhe të rinjtë nuk

e spiegonin dot, sepse nuk e kishin dëgjuar kurrë një britmë të tillë.

Të nesërmen, burrat e fshatit, para se të nisnin punën, nuk kishin bisedë tjetër. Secili çfaqi mendimin e tij. Dikush tha se mos ka qenë ndonjë dosë që është mbytur në baltë, tjetri e bëri gomar që pliste, një i tretë tha se duhet të jetë viç. Kur erdhi Petrua, puna u ngatërrua keq:

— Jo, shokë, — tha ai. — Unë e pashë me sytë e mi që s'ishte as dosë, as gomar, as viç. Mbrëmë kam shpëtar për një qime. Po vija natën në shtëpi, si zakonisht, kur dëgjoj një si rënkim të thellë. Ndalova që të mbaja vesh, kur nga kallamishtat u ngrit një gjë e zezë sa një bina, dhe lëshoi atë britmën e frikshme që keni dëgjuar. Nuk isha as dhjetë metra larg dhe pashë me sytë e mi si u përkulën kallamat nga fryma e saj, që ishte kaq e fortë sa më rrëzoi edhe mua për tokë! Unë e di si kam shpëtar mbrëmë.

Të rintjtë qeshën dhe dikush e pyeti me qesëndi:

— E çfarë ishte?

— Sigurisht ndonjë kuçedër — u përgjegj në vend të Petros një i ri dhe ja plasi gazit.

— Të janë bërë kallamishtat kuçedër, nga frika — shtoi prapë një tjetër.

Dhe ata nuk e pushuan gazin.

Po pleqtë u vrejtën. Ata as nuk qeshën si të rinjtë, as nuk thanë gjë, vetëm tundën kokën.

Me t'u ngrysur filluan të dëgjoheshin prapë rënkimet e britmat, herë më larg e herë më afër. Po kështu edhe të nesërmen dhe të pasnesërmen. Fshatarët, rrëth e qark kënetës, as nuk prisnin të ngrysej mirë, por pa u errur mblidhnin bagëtinë e i vinin llozin shtëpisë. Asnjeri nuk bariste tashti natën. Edhe të rinjtë i pushuan shakatë. Ata i dëgjuan me vëmendje disa herë këto britma dhe nuk mund të spiegonin se çfarë kafshe ishte. Këto klithma e vikama të frikshme ishin të panjohura përtë. Por tashti që as të rinjtë, me shkencën e tyre, nuk dhanë dot spiegime, u erdhi radha pleqve të «sqaronin» dhe ata filluan të tregojnë përsëri përrallat e legjendat e harruara. Më plaku i tyre, Kozma Nasi, duke i nxjerrë fjalët dalngadalë, si me darë, tha i menduar:

— Më dëgjoni mua: ai është Bualli i Kënetës, ai që ka jetuar gjithmonë në fund të kënetës. Ju po e thani kënetën, prandaj ka dalë. Kjo është shënjë e keqe. Ai nuk do

t'i thahet këneta. Kam frikë se do të na bëjë ndonjë hata! Më dëgjoni mua!

Disa të rinj u tallën me këto budallallëqe, por të nesërmen fshatarët nuk i afro-heshin më kënetës as ditën. Madje edhe peshkatarët nuk shkuan më të gjuanin. Ata nxorën si shkak meremetimin e rjetave dhe nuk u tundën fare nga vendi. Pastaj dikush u ankua se i kishte humbur një derr, një tjetër se nuk i kishte ardhur zاغari në shtëpi, dhe një i tretë dha alarmin se i kishte humbur kau. Të gjitha këto humbje nuk mund të spiego heshin, veçse me Buallin e Kënetës që i kishte përpirë.

Bardhyl Leka, sekretar i rinisë së fshatit, vendosi ta sqaronte këtë çështje, sepse, mendoi, më mirë të ndizte një qiri, sa të mallëkonte errësirën. Ai nuk i besonte përrallat e pleqve për «Buallin e Kënetës», por prapë nuk ishte në gjendje ta spiegonte se çfarë kafshe ishte ajo, që kishte tmeruar fshatarët me britmat e saj. Nga të gjitha kafshët që njihte, asnjera nuk kishte këtë zë. Puna më e mirë, mendoi, është të kontrollohet këneta dhe të vritet kafsha. Por gjuetarët e fshatit ato ditë kishin humbur. Ata gjuanin rosa në grykën e lumit apo, fare, në breg të detit, shumë larg vendit ku ishte

dukur kafsha e panjohur. Prandaj ai kërkoi ndihmën e shoqërisë së gjuetarëve të qytetit, e cila të nesërmen u dërgoi një skuadër gjahtarësh, të zgjedhur si kokrrat e qershisë, nga më të mirët. Në krye të saj ishte Avni Ballgjini, një burrë i gjatë e nishanxhi i dëgjuar. Ata u grumbulluan në shtëpinë e Kozma Nasit, që i priti me gjela deti.

Duke pirë raki rrëth oxhakut, ata bënë planin si ta rrethonin kënetën.

— Më dëgjoni mua — u thosh Kozma Nasi. — E keni kot. Është Bualli i Kënetës. Ai as nuk kapet as nuk vritet. Do të mirrni veten më qafë.

— Lena rehat me këto përralla, o xhaxho — i tha Avniu dhe, duke u kthyer nga shokët, vazhdoi: — Unë mendoj, shokë, ta rrrethojmë vendin dhe me të filluar britmat t'i afrohemë nga të gjitha anët dhe ta vrashim.

— Mirë, po na duhen nja dy varka dhe thonë se varkat e peshkatarëve janë shpuar.

— Atë e rregullojmë. Unë po shkoj me një varkë. Kush po shkon me tjetrën?

— Unë — tha Mihali, një gjuetar i vjetër.

— Ja pra, tha Avniu, ju rendituni në buzë të kënetës dhe ne po vemi me varkë

nga të dyja anët. Sonte duhet ta sqarojmë këtë punë.

— A s'ka mundësi ta bëjmë nesër, ditën?

— pyeti dikush?

— Jo, ditën ajo shkon në det, prandaj duhet ta bëjmë sonte.

— More, më dëgjoni mua, — u hodh prapë Kozmai, — është Bualli i Kënetës. Nuk e vrisni dot...

Aty, në të errur, ata u rreshtuan buzë kënetës. Avniu u hodh në varkë, por varkëtari që ishte me të, diçka ngatërronte në fund të saj, duke hequr ujin me kovë.

Bardhyl Leka, me dy të rinj, ndezi një zjarr në buzë të kënetës dhe ndëri duart pér t'u ngrohur.

Binte një shi i hollë.

Nata erdhi ngadalë. Zhurmat në kënetë filluan të qetësohen. Sipër gjahtarëve fluturonin rosat. Herë-herë çafkat lëshonin britmat e tyre të holla. Të gjithë prisnin me ankth në vendet e tyre, tridhjet metra larg njeri tjetrit. Dikush nga padurimi ndizte e shuante cigaret. Një tjetër ndërronte e shndërronte fishekët e çiftes, kurse një i tre-të dridhej nga të ftohtit. Herë pas here ata i fërshëllenin njeri tjetrit.

Një fllad i lehtë filloi të fryjë e të

lëvizë kallamishtet. Nga këneta erdhi një erë e keqe, pastaj u dëgjua një rënkim e nuk shkoi shumë dhe britma që kishte llah-tarisur fshatarët, çau ajrin.

Bardhyl Leka, po priste të dëgjonte të shtenat e çifteve, kur për çudi vuri re se gjithë gjahtarët u gjëndën rrëth e përqark zjarrit.

- E dëgjuat? — pyeti njeri.
- E dëgjuat? — ja pat tjetri.
- More, ç'qenka kjo kështu?!
- Jo. Kjo nuk është kafshë.
- Ec të ikim. S'është punë për ne!

Avni Ballgjini ishte duke shtyrë bar-kën, kur dëgjoi britmën. Pa dashur u drodh dhe i hyri një frikë, që s'e kish ndjerë kurrë më parë. Megjithatë ai nuk u tërhoq.

— Nise! — e urdhëroi shokun e vet, një peshkatar që kishte marrë përsipër të voziste.

- Por barka nuk u nis.
- Nise! — i bërtiti.
- E si ta nis? — A nuk e sheh se është mbushur plot me ujë? — u ankua peshkatar, duke iu dredhur zëri. — S'kemi ç'bëjmë shoku Avni, kthehemë.
- A s'ka mundësi ta hiqni ujët?

— Jo. Varka éshtë shpuar — gënjeu tjetri.

Avni Ballgjini mallëkoi, shau nëpër dhëmbë e doli në breg. Në të vërtetë ai ishte i gëzuar që gjeti një arësyё të fortë për t'u térhequr nga kjo punë.

Pranë zjarrit u bërtiti shokëve:

— Po ju, pse jeni grumbulluar këtu?  
Pse kini lënë vendet e caktuara?

Asnjeri nuk u përgjigj.

— Po Mihali ku éshtë?

Prapë heshtje. Disa ngritën supet.

Një rënkim filloi të vinte nga këneta, pastaj britma dhe pa pritur një krismë pushke dhe një thirrje e zgjatur e një njeriu të trembur. Një përplasje e menjëherëshme e një trupi në ujë dhe pasaj plaq e pluqet e një diçkaje, që lëviz në kënetë, drejt bregut.

— Ajo éshtë — tha njeri nga gjahtarët.  
Po vjen drej nesh!

— Të ikim, o burra!

Dhe pa pritur njeri tjetrin, ata ja dhanë vrapiit në rrëmujë drejt fshatit. Vetëm Bardhyl Leka dhe Avniu qëndruan.

— Ku shkoni, more të marrë? qëndroni!  
— bërtiste Avniu, ndërsa Bardhyli thërriste gjahtarin që mungonte:



— Mihal! O Mihal!

.....  
Në shtëpinë e xha Kozmait, gjahtarët,  
rreth e qark zjarrit, diskutonin si të verbë-  
rit, që bisedojnë për ngjyrat.

— Ju thashë, o burra, nuk keni ç'i bëni;

është Bualli i Kënetës. Na dëgjoni edhe ne pleqve për këto punë — thoshte Kozmai.

— A e pe si u ngrit nga këneta, si një re e zezë? More se çfarë hata që ishte — tha njeri nga gjahtarët.

— Po flakën që lëshoi nga goja, nuk e vutë re?!

— Ju thashë, është kuçedër! — ja pat tjetri.

— Përralla! Duhet të jetë ndonjë kafshë që nuk e njohim.

— E ku ka kafshë të panjohura sot, sidomos në anët tona?

— Kush e di?

— Dëgjoni se ç'ka ndodhur andej nga Dhërmiu para pesë-gjashtë vjetësh, në kohën e fashizmit: Na ishte një bari që ruante lopët fare në buzë të detit. Një natë dëgjon një britmë të tmerershme dhe fshihet pas një guri. Edhe lopët u mblodhën grumbull në mes të livadhit. Kur nga fundi i detit del një buall i madh, i bardhë krejt, si borë. Sa doli në breg, lëshoi një britmë sa që tundi dheun e dallgët filluan të ngrihen të dalldisura, kurse një çast më parë deti ishte fare i qetë.

— Po pastaj ç'u bë?

— As pa më tutje bariu, po ja dha

vrapit e në katund. Vetëm të nesërmen pa se i mungonte një lopë.

— Më dëgjoni mua. Është Bualli i Kënetës — përsëriti Kozmai.

— Eh, çfarë paska kjo dynja!  
Dikush trokiti.

Hyri Mihali krejt i lagur. Pas tij një burrë i thatë, varkëtari, edhe ai i lagur, dhe në fund Avniu me Bardhylin.

— Zjarr, o burra, se vdiqëm!  
— Hapni vend këtu.

Të porsaardhurit zunë vend afër zjarrit dhe Mihali me varkëtarin filluan të thanin rrobat.

— Çfarë ndodhi?

— Lere se ç'na panë sytë sonte! — tha varkëtari.

— Ti shtive?

— Unë. — u përgjegj Mihali.

— Epo ç'ndodhi?

— As unë nuk e di.

— Pa na trego.

— Ja. Sa dëgjova rënkimin i thashë Leksit ta nisë varkën. Ky i uruar e nisi, por jo në drejtimin e zërit, po në të kundërtën. More ç'bën kështu? — i thashë, kurse ky jepu remave.

— Ehe, pse, budalla më bëre ti mua? T'i

vete kuçedrës në gojë! — ja priti Leksi,  
duke ndërur këmishën për ta tharë.

— E, që thoni ju, po i afroheshim bre-gut, kur na vjen prapa një si re e zezë. Ne ik, ajo pas. U bëmë njësh me varkën. Atë-here shtiva. Leksi lëshoi një britmë, u më-njanua dhe e përbysi varkën dhe ne ramë të dy në kënetë. Shyqyr që nuk kishte shumë ujë, se do të ishim mbytur. Mezi kemi dalë, ja, siç na shihni.

— Po ç'ishte, vallë?

— Djalli e di se ç'është.

— Është kuçedër — tha Leksi dhe pa pritur murmuriti me zë të ulët, me vete:

— O Zot, o Shënmëri, shyqyr që shpëtova, për ata kalamaqër, një herë! — E që thoni ju, shokë — vazhdoi duke ngritur zërin, — flakë nxirrte nga goja! i kishte sytë sa një rrotë maqine, gojën e hapur sa një derë furre, dhëmbët me kanxha si plugje traktori! Sa gjë e llahtarshme! Na shpëtoi Zoti sonte!

— Më duket se po flet kuturu, po i zmadhon gjërat.

— Ashtu thua ti se s'ishe aty, po të ishe!... sidoqoftë, unë me këtë punë nuk merrem më.

— As unë. Ta dinim se ç'ishte, hajde de,

po as nuk e dimë se me çfarë kemi të bëjmë.

— Të lajmërojmë Tiranën. Vetëm ata të qendrës mund ta zgjidhin — propozoi dikush.

— E ç'do t'i bëjnë ata?

— Ama ç'pyetje! Ata kanë më shumë kompetenca.

— Bëni ç'të doni.

— Unë mendoj të lajmërojmë kryesinë e shoqërisë së gjuetarëve — shtoi një tjetër.

— E ç't'iu themi?

— T'iu themi se ka ardhur një kafshë, e panjohur deri më sot.

— More, më dëgjoni mua. Është Bualli i Kënetës — tha prapë Kozmai.

— Është kuçedër — tha Leksi.

— Dragua, them unë!

— Mos more! — u tall Avniu.

— Çfarëdoqoftë është diçka e panjohur dhe e panjohura gjithmonë të këllët frikën — tha një gjuetar.

— Këtu ke të drejtë. Ja, ç'më ka ndodhur mua, kur isha ushtar — tha Mihali. Shkoja për të shpurë një letër në komandë. Më zuri nata në mal. Gjeta një vend të sheshtë dhe thashë të flija pak. Sa u shtriva vura re se ndodhesha sipër një varri dhe rrëth e përqark varre të tjerë. Tani dini si

m'u drodh zémra! E dija se tē vdekurit nuk ngrihen nga varri, dhe nuk besoja as atëhere lugetér, por do ti se s'më zinte gjumi. Pa më hypi pastaj një frikë e madhe e po dridhesha i téri. Nuk durova dot dhe u nisa. Ke parë ti? tē jesh i sigurtë se nga tē vdekurit nuk tē gjen gjë dhe prapë tē kesh frikë!

— Edhe mua kështu më ka ndodhur një herë — u hodh një gjahtar i vjetër. — Isha i vogël atëherë dhe punoja me karvan rrugën e Korçës, pas babait tim. Një herë na zuri nata afër varrezave. Lidhëm kuajt aty pranë dhe ramë. Sa pa na zënë gjumi dëgjojmë rënkimë: hëm.. hëm... hëm!.. Bobo, thamë, u ngjallën tē vdekurit, dhe o burra kush tē ikë më parë. Mirëpo harruam tē zgjonim një shokun tonë. Po pse, kishte burrë tē kthehej prapë e ta zgjonte? Atëhere filluam ta thërrisnim dhe ta gujanim me gurë. Mirëpo ai flinte top! Gërhiste sikur ishte në dyshek pranë gruas. Kur ja dhamë me popël kokës, u zgjua duke thirrur e duke sharë.

More, lere se kush tē ra, i bërtitëm, po çohu se tē zuri lugati! — Ai sa dëgjoi rënkimet u hodh përpjetë dhe, ashtu siç ishte, në brekë, ja dha vravit, duke u penguar e rrëzuar nëpër varre... Kur vajtëm tē nesër-

men, ç'të shohim!? Aty afër na paska qenë një viç i lidhur!...

Me kësi përrallash ata e gdhinë atë natë dhe të nesërmen secili shkoi në punë të vet.

Misteri i kënetës mbeti i pasqaruar. Tashti filluan të hapen lloj-lloj spiegimesh, sepse errësira bëhet më e thellë kur shuhet drita. Shoqëria e gjuetarëve të Tiranës mori disa telegramë urgjente, për të organizuar ekspedita që të sqaronte punën. Dikush i shkroi një relacion Institutit të Shkencave dhe disa bënë propozime që të lajmëronin ndonjë repart të ushtrisë, për ta rrethuar kënetën e për ta rrahur me top!

Ndërkohë njerëzit mbylleshin herët në-për shtëpi. Peshkatarët nuk gjuanin më dhe të gjithë i shmangeshin rrugës buzë kënetës, jo vetëm natën, por edhe ditën.

Bardhyl Leka, sekretar i rinisë së fshatit, rrinte si më gjëmba. Atij i vinte turp dhe hante veten me dhëmbë që nuk e kishte çuar deri në fund e nuk kishte sqaruar punën e kafshës së kënetës. Ai nuk besonte as përrallat, as legjendat, që po thureshin tashti rreth kësaj kafshe të panjohur. Ai e dinte se njerëzit gjithmonë kanë pasur frikë nga errësira dhe i janë trembur së panjohurës,

por errësira nuk është gjë tjetër veçse mungesë e dritës dhe e panjohura mungesë e dijes. Për të çarë errësirën e për të zbuluar të panjohurën, duhet, në radhë të parë, të mposhtet frika që mpinë mëndjen dhe dobëson vullnetin. Kur njerëzit nuk e arrijnë dot këtë, shpikin e trillojnë gjithëfarë legjendash e besimesh të kota për t'u justifikuar. Ja, edhe tashti, jo vetëm po përsëriteshin legjendat e vjetra, por po trilloheshin edhe të reja. Ai sa nuk tërbohej kur i dëgjonte këto dhe e ndjente veten fajtor. Jo, thoshte me vete, tek ne këto nuk duhet të kenë jetë të gjatë. Bashkë me kënetat, ne duhet të zhdukim edhe legjendat!

Prandaj ai e vendosi dhe, duke marrë me vete katër të rindjeve, shokë të tij, iu fut vetë kënetës, këtë radhë i vendosur që ja ta vriste kafshën e panjohur e të sqaronte këtë mister, ja të humbiste fare.

Prandaj, ende pa u gdhirë, u fut i pari në kënetë, duke i hypur varkës së Mihalit, pikërisht asaj varke, që ishte përmbytur atë natë dhe asnjeri nuk ishte kujtar ta kthenëte mbarë. Ai hyri thellë në kallamishtet duke vozitur me kujdes, kur pa pritur, disa hapa para tij, u duk një kafshë e madhe, e zezë, që mezi lëviste, duke hapur rrugën

kujtua në çast se e kishte parë diku, në një libër, këtë lloj foke apo luan deti, por nuk e vau mëndjen ta caktonte se çfarë ishte. Pa humbur kohë i zbrazi të dyja grykat e çiftes, duke shënuar drejt e në kokë kafshën. Pastaj u hodh nga varka në ujin e cekët të kënetës, rrëmbeu lopatën dhe e goditi disa herë kafshën, që po përpëlitez. Pastaj thërriti shokët. Ata e nxorën me vështirësi në breg kafshën e vrarë.

Disa fshatarë u grumbulluan rreth saj, duke e vështruar me kureshtje. Ndërmjet tyre qe dhe Kozma Nasi, plaku i moçëm, që ngulte këmbë për Buallin e Kënetës.

— More, sa e madhe qënka! Ke parë ndonjëherë kafshë të tillë?

— Kurrë! Unë nuk marr vesh, — kafshë apo peshk është?

— Trupin e paska si të peshkut, por kokën...

Edhe Kozma Nasi vështronte i habitur.

— E xha Kozma — tha Bardhyli me të qeshur, — ta vramë Buallin e Kënetës.

Ai tundi kokën dhe tha me zë të ulët:

— E vratë! Me të vërtetë e vratë!

Dhe vazhdoi të tundë kokën, sikur po shkundte legjendat dhe bestytnitë, që kishte grumbulluar në të.

## SELIM SAKATI

Selim Sakati ishte nga Trueni i Pukës. Edhe pse i vorfën sa s'thuhet, Selimi ishte kurdoherë gaztor dhe i gëzueshëm. Ç'e do se i patën ra disa halle që ja turbulluen pak qejfin. I vdiq papritmas baba dhe iu desh të hyjë bukur thellë në borxhe, për t'i ba drekët simbas zakonit. Veç kësaj zu një nuse për vëllanë e tij ma të vogël e i duheshin pague t'et të nuses njëzet e pesë napolona të kuq. Pra, me fjalë të tjera, i duheshin pare. E mbasi pare të ruejtuna s'e kish pasë zakon të kishte, as ai, as katundi mbarë, u detyruë të shiste një copë të mirë pylli, që e kishte trashëgim nga të parët. Blerësi, një hanxhi që banonte në Sakat, kërkoi të bashedhin formalitetet te noteri. Selimi s'ish marrë ndonjëherë me shitje e blemje. Nuk e dinte se kjo puna e noterit kishte bishta me këmbët e saja të vogla si lopatë. U

shumë. Atje te noteri ai mori vesh se nuk e kish çregjistrue babën nga defteri i të gjallëve, në mënyrë që mandej të mirrte përsipër si trashëgimtar pasuninë, e cila figuronte gjithnjë mbi t'anë.

Ju desh, pra, të shkonte në komunen e tij, në Vakeqe të Pukës, të çregjistronte babën dhe të mirrte një dokument se baba kishte vdekë.

Atje në Vakeqe ka pasë qenë kryetar komuneje njëfarë Sali Rizaj, pijanec i çartun, thue se e kish pjellë kazani për grykë. Kur ngrihej në mëngjes i dridheshin duert si me qenë i paralizuem. Pa e rrëkëllye kungullin e rakisë, nuk i çeleshin sytë. Saliu e pinte rakinë në mëngjes, në drekë, pasdreke, në mbramje e deri sa ta zinte gjumi tue pi. Mbasi pija e mezet kërkonin shpenzime, e Saliu nuk i kishte fort qejf shpenzimet, bante si bante e pinte katundeve. Bridhte punë e pa punë katundeve të komunes së vet. Po sa binte në shtëpinë e ndonjë katundarit përsëriste gjithnjë këtë avaz: — Mos u trazoni për mue. Unë bukë, po thuej, s'ha fare. Unë due vetëm raki dhe pak meze: zorrë e mushkëni. Mbasi atje majë malesh nuk kish kasap kund, për të ble zorrë e mushkëni që kërkonte kryetari, fshatari i

shkretë, që i kish fëmijtë cullak si mish në sahan, detyrohej të priste një bagëti. Kësh-tu i ripte kryetari ata fshatarë të këputun, që mezi mbanin shpirtin. E jo vetëm krye-tari. Shok i ngushtë i tij për punë gote ishte dhe sekretari, njëfarë Koço Llezho nga Për-meti. Të dy vinin nga trupi të gjatë e të thatë, të dy kishin pak a shumë të njajtën moshë. I kish bashkue djalli vetë, tamam si një pendë qe.

Sa për pijanec, Saliu ja kalonte pak Koços. Ndoshta edhe Koçua nuk do të kish mbetë mbrapa sikur të pinin nga ajo rakia e Përmetit, që digjet sa t'i vesh shkrepsen. Rakia e Pukës ishte e butë e Koçua ende s'ja kish marrë dorën.

Harrova të them se mezet, (doemos, kur pinin në shtëpi të Saliut ose në zyrë), ua përgatiste grueja e Koços, e cila ishte greke, nga Larisa, dhe babën e kish pasë mejha-nexhi. Mezet që pregatiste ajo, Saliu s'i kish hangër as në Tiranë; megjithse këta vitet e fundit Saliu hante meze pak e pinte raki shumë.

Atë ditë, që u nis Selim Sakati për në komune të Vakeqes, për të ba çregjistrimin e t'et, Saliu e Koçua po pinin në zyrë. Por mos kujtoni se pinin nga xhepi. Në Vakeqe

kish vdekë një burrë i vjetër. I biri, për ndërim, çoi e thirri në mort edhe kryetarin e komunes. Saliu, që dinte t'i shfrytëzonte mirë këto raste, ju fal nderës ftuesit, i uroi xhenetin të vdekunit dhe i tha që mishin e rakinë t'ja dërgonin në zyrë, mbasi kishte punë e nuk mund të vinte tek i vdekuni. Kështu, tashti, ai ja kish shtrue për shtatë qejfe mu në zyrë të komunes; bashkë me sekretarin. Xhandar Sefedini, të cilin kryetari e mbante afér se ish i zoti si për punë gote, si për çdo punë tjetër, po rrinte n'oborr të komunes në një hie, me një shishe raki para dhe një shpatull berri në dorë. Ndërsa kryetari conte kungullin hova-hova, tue i sha shpirtin të vdekunit për qejf të gojës, ja behi Selimi. Sefedini, habitë mbas rakisë e sidomos mbas mishit të majmë, nuk e kish vu re Selimin kur u fut në komune, se nuk do ta kish lanë të hynte. Ai kishte urdhën të ndalonte çdo njeri e t'i thoshte se kryetari asht i zanun me punë të randësishme.

Selimi, si me ja ndi zemra një gja të tillë, s'i bëzani fare Sefës dhe u fut në zyrë si hajdut.

- Mirëdita dhe iu baftë mirë, o zotni,
- përshëndeti njerzisht Selimi.
- Po ti? — E pyeti Saliu, tue e shikue

me ata sy tē zgurdulluem e tē ndezun si kandila.

— Kam ardhë, o zotni...

— More cili je ti, emnin thuej — ja preu fjalën nē gojë kryetari.

— Selim Sakati.

— Nga Sakati i Pukës?

— Jo, nga Trueni.

— Gënjen, derr.

— E pse po tē gënjej, o zotni? — iu përgjegj me një gjysmë zemërimi Selimi.

— Unë tē njof nē fytyrë se ti je nga Sakati.

— Mirë, o zotni, se unë s'kam ardhë për këtë punë... — desh tē vazhdonte Selimi i shkretë, por prapë ja zu fjalën nē fyt kryetari.

— Mos u ikë fjalëve, zagar, thuej jam nga Sakati!

— Mirë, nga Sakati jam! — foli gjithë inat Selimi.

— Jo, mirë, mirë sa me tē ba qejfin, viç i pa lëpimë. Ti tē më bajsh qejfin mue!?

— Zoti kryetar, dale se po shikoj unë regjistrin e Truenit, — ndërhyjni Koçua dhe kapi një regjistër tē madh nē dorë.

— Shiko, — iu kërcnue Saliu Selimit,

— po gënjeve, emni i Zotit tē nis tashti

në kambë për Sakat, që të më sjellësh dy shishe raki.

— Selim Sakati, Selim Sakati... murmuroi Koçua dhe në fund thirri:

— E gjeta. Ja ku asht, Selim Sakati prej Trueni, zoti kryetar.

— Po pse nuk thue se jam prej Truenit, more rezil? — thirri kryetari.

— Unë besa shqip të fola një herë, — iu përgjegj flakë për flakë Selimi.

— Shikoje dreqin, don me më gënje sy për sy.

— More zotni kryetar...

— Pusho delenxhi! E di se je para kryetarit të komunes këtu? E di se në këtë karrigë më ka vu ai? — dhe tregoi portretin e Zogut. — Ja, e shikon? Cili asht ai?

— Mbreti! — tha Selimi.

— Mirë mbreti, po si quhet.

— Zogu.

— Zogu i tyt'et — iu kërcnue kryetari. Naltmadhnia e tij, Zogu i Parë, kështu thuej, gomar. Edhe i thue vetes shqiptar! Hajt, fol tashti pse ke ardhë!

— Po bash këtë due me thanë, more zotni, kaherë, po ti nuk po më len! — foli e fshani thellë Selimi. — Kam ardhë të marr tek ju një dorë se më ka vdekë baba.

— Ashtu fol, dreq. Ke një orë që ban llaka-llaka.

Koçua u ngrit e kapi prapë regjistrin e maparshiën.

— Si quhej baba? — pyeti Koçua.

— Bajram Sakati.

— Bajram Sakati, Bajram Sakati... Ja, Bajram Sakati. Po dale. Baba yt nuk ka vdekë ende.

— Si s'paska vdekë? — tha Selimi e bani buzën në gaz.

— Jo! Këtu baba figuron i gjallë.

— Po pse gënjen, more jezit!? — iu përvesh kryetari. E len babën gjallë e shëndosh në shtëpi e vjen e kërkon këtu një vërtetim se ka vdekë?

— Mos u tallni me të vdekunin, zotni!  
— foli si në lutje Selimi.

— Si tallesh, mor malok i dreqit! Edhe tallesh në zyrat e komunes, që asht njësoj sikur të tallesh para qeverisë e Naltmadh-nisë.

— Baba ka vdekë, mor zotni, — thirri Selimi i inatosun.

— Gënjen, maskara! — bërtiti me të madhe kryetari.

— Po unë e kam vorrosë me duert e mia!

— E çfarë don tē vërtetosh ti me këtë?

— Due tē vërtetoj se një njeri që hyn në vorr dhe i bien dymijë kilo dhé sipër, edhe nëmos pastë vdekë deri atëhere, vdes aty brenda. Pra, baba ka dy muej, që i ka ato dymijë kilo dhé sipër, atje në gropë tē vorrit. Pra, baba ka vdekë.

— Edhe s'të vjen turp tē tallesh me babën, more rezil.

Ti vetë po më shtyn, zotni kryetar, — iu zbërthye gjuha Selimit. — Më thue se nuk tē ka vdekë baba. Unë kam hy në borxh deri në fyt pér t'i ba drekët. Në drekët e tij kanë ngranë bukë tri copë katunde. N'ato dreka ka hangër e ka pi edhe xhandar Sefedini. Pyete po deshe.

— Do ta pyes, pos! — tha kryetari e bërtiti tē madhe: — O Sefë, o Sefë.

Sefa, me bulçi plot e pa kapelë, erdh e u paraqit gatitu te kryetari.

— Urdhno, zotni kryetar, — foli tue u përtypë.

— Ore Sefë, di gja ti, a i ka vdekë baba këtij?

— Ku e di unë! — tha Sefedini si ja lëshoi sytë njëherë Selimit.

— Pse, a s'ishe ti në Truen para dy

muezsh, në drekët e Bajram Sakatit? —  
ndërhyjni menjëherë Selimi:

Isha! — U kujtue Sefa.

— E pe ti me sy Bajramin vdekun? —  
e pyeti kryetari.

— Unë drekët ja hangra, zoti kryetar,  
mish e raki sa desha. Po a kish vdekë a  
s'kish vdekë Bajrami, nuk e vuna re.

— E shikon? — e pyeti kryetari Se-  
limin.

— Çfarë të shikoj? — tha Selimi i ha-  
bitun.

— E shikon se baba yt nuk ka vdekë?

— Aman, more zotni, — thirri atëherë  
me dëshprim Selimi. — Kam ba katër orë  
rrugë për t'ardhë deri këtu.

— Ne nuk mund të japim asnje vër-  
tetim pa ba çregjistrimin ma parë, — ndër-  
hyjni Koçua.

— Mirë, banie çregjistrimin. Unë mund  
të pres, — iu përgjegj ai. — Vec iu lutem  
mos më nisni pa gja.

— Po dale njëherë, — vërejti kryetari,  
tue i turbullue sytë ma zi se i kishte.

— Pse të vdiq baba?

— Vdiq se e kishte kohën. — iu për-  
gjegj pa të keq Selimi.

— More pse vdiq, më thuej ti!

— Vdiq, more zotni, si vdesin tē gjithë dyniaja. U ftof duket, nj'a dy ditë përpara, ra në shtroje e vdiq.

— Po sikur ta kesh mbytë ti babën? — foli kryetari e ashtu, i dejshëm, u mundue tē mbyllte njenin sy gjasme sikur i ra në te.

— S'ua kam ngenë shakave. — iu përgjegj Selimi pa ja ba tē gjatë. Nga kjo përgjigje Saliu u nxeh keq. Papritmas rrahu grushtin pér tryezë. Kërciti pjatat dhe desh u rrëzue shishja e rakisë, por e priti Koçua.

— Nuk ka vërtetim, — bërtiti me atë zanin e tij tē shkyem. — Kjo komune nuk formon bindje tē plotë se baba yt ka vdekë.

— E çfarë duhet tē baj unë, zoti kryetar? — pyeti, tue e përbajtë veten Selimi.

— Duhet tē më bindësh me prova.

— E ç'janë këto prova?

— Ja, pér shembull, tē më sjellësh një vërtetim nga ai, me tē cilin tē vërtetohet me dorën e vet se ka vdekë.

— Ej, medet — ofshani Selimi. — Ai s'ka dijtë shkrim kur ishte gjallë, more zotni, jo ma tashti, që po i bahen dy muej në vorr.

— Sa muej, the?

Dy muej e pesë ditë.

— Do tē ketë mësue. Pa tjetër do tē

ketë mësue. Në atë jetë i mësojnë njerëzit këndim e shkrim për tri javë, kurse këtu mësuesat e dreqit rrinë nandë muej e s'u mësojnë fëmijëve kurrgja. Hanë kotë arkën e shtetit.

— Si t'ja baj, zotni kryetar? — pyeti prapë për hallin e vet Selimi.

— Ashtu pra, si të thashë. Sille dorën nga yt atë e merr vërtetimin.

— Po ai i shkreti nuk lëshon dorë ma, more burrë!

— Atëhere, po nuk desh të lëshojë dorë, le të vijë vetë e të kërkojë vërtetimin se ka vdekë.

— Tashti i re në te — foli Selimi, sa pa plasë nga inati.

— Ashtu, pra, djalë i mbarë, — iu përgjegj kryetari.

— Do t'i them të vijë vetë e ta marrë!

— Të vijë posa!? Ik tashti se na mërzite. Mos harro t'i thuesh babës të vijë.

— Jo, jo — iu përgjegj Selimi e duel përjashta.

Saliu dhe Koçua u shqyen gazit. I shanë shpirtin mbarë e prapë atij të Vakeqes dhe babës së Selimit dhe i çuen shishet me fund.

Selimi doli nga komuneja pikë e vrer. Një herë i shkoi mendja të kthehej në shtë-

pi, të merrte atë pushkën e fshehun, që i pat lanë i ati dhe t'i bante të dy turshi mu aty, në komune. Mirëpo, si i kaloi ajo zjarrmia e parë dhe zu të shoshitë me vete se çfarë do të ndodh te mbrapa, ndërroi mendim. Mbası katundin e kish larg, vendosi ta kalojë natën në shtëpinë e kumarës Halil Treshit, aty, në Vakeqe. Halili vërtet ish trim, por edhe i urtë. Ai mund t'ja largonte këtë siklet dhe ta këshillonte për së mbari. Hap-hap, tue u përplasë ndër mendimet e veta, Selimi arriti te shtëpia e kumarës.

Sulltana, gruaja e Halilit, u çudit kur e pa. Nuk i kish ngelë fytyra as një perçik. Ishte zverdhë sikur ta kishin zanë një javë ethet. Grueja e shtini mbrendë, i bani një kafe dhe u përpoq të zbulojë ku e kishte të keqen e hallin. Mirëpo Selimi as me folë nuk dinte, le ma, që gazi e gjëzimi i zakonshëm i kishin humbë fare. Si muer vesh se Halili ishte te tokët, s'dijti si e piu atë kafe, i mori lejë Sulltanës dhe u nis fill atje.

Gjithë rrugës po mendonte si mund t'ua punonte qindin atyne të komunes. Dikur, papritmas e gjet shtegun. Menjëherë iu zdrift fytyra dhe iu dha një gaz pa dashë. — Do t'ua punoj atyne, që të çuditen, — tha me vete.

Loja që po mendonte të bante Selimi ishte me rrezik. I duhej pa tjetër edhe ndihma e kumarës. Kumarë Halili s'u kursye aspak. Si mori vesh çdo gja, jo vetëm që e pëlqeu planin e tij, por edhe i dha zemër që ta zbatonte deri në fund.

Si filloi t'erret, vanë e u siguruen mirë se xhandar Sefedini kishte shkue në shtëpi të vet, në një katund aty përbri. Sefedinit ja kishin frikën, se ish pak i krisun e mund të shtinte në ta. Dalngadalë iu afruen komunes. Selimi kambas e doras arriti xhamin e dritäres dhe pa nëpër të, në dritë të kandilit, kryetarin e sekretarin që po pinin gjithnjë.

Halili, që kish edhe pushkë, ndenji roje; Selimi, simbas planit, u çvesh lakuriq deri në brez, çeli strajcën e blozës, që kish sjellë me vete dhe zhigati trupin, krahët e fytyrën. Pastaj vuni mbi kokë një çarçaf të bardhë, që i mbërrinte deri te kambët. Mbi kokë rrasi qeleshen. Dukej, ashtu nëpër terr, dishka me të shti hatanë. Mbështolli çarçafin rreth vetes e u nis fill e te dhoma e kryetarit të komunes. Trokiti randë në derë.


— Kush asht? — thirri me za të çjerrun kryetari.

- Jam unë, — e trashoi zanin Selimi.  
— E cili na qenke ti, tash natën?  
— Jam unë, Bajram Sakati.  
— Cili? — pyeti pa e marrë vesh se kush ishte ky emën.  
— Bajram Sakati.  
— E ç'dreq kërkon?  
— Kam ardhë se më keni thirrë.  
— Ik, or budalla. Dreqi të ka thirrë ty. Eja nesër, nesër!

U ba një heshtje e gjatë. Burrat zunë prapë nga pija e nga muhabeti kodra mbas bregut. Dang, dang! përsëri dera e odës.

= More kush dreqi je ti? = thirri  
me inat kryetari.

— Bajram Sakati, — u përgjegj prapë ai za i trashë.  
— E çka lypë?  
— Ju keni çue me më thirrë.  
— Pa çele pak atë derë, o Koço, ta shikojmë cili asht ky hajvan, që vjen e na trazon natën. — Koçua, tue u marrë kambësh, u ngrit e çeli derën. Merreni me mend si u ba Koçua i shkretë, kur pa atë lugat aty përrpara. Së pari i iku pija, sikur ja hoq kush me dore. Përnjehere iu morën mendtë e gati sa s'u rrëzue. S'dijti i shkreti se ç'të



bajë, por ngau vrap e u fsheh mbas kryetarit.

Fytyra e të vdekunit e paniku i Koços e tmeruen edhe kryetarin. U ngrit burri, shtyni Koçon e u fsheh mbas tij. Njeni shtyj, tjetri shtyj, rrëzuen pjatat e shishet e rakisë përdhe.

— Mos u trembni, — u thirri lugati.  
— Unë do t'ik menjëherë.

— Çfarë don, o shpirt i trazuem, — pyeti tue u dridhë Saliu. Edhe ky ishte ba esull fare nga frika.

— Çfarë doni ju, që më keni thirrë? — u përgjegj lugati.

— Cili je ti? — mezi foli kryetari.

— Jam Bajram Sakati, baba i Selim Sakatit. Selimi m'erdh sonte te vorri e më tha: «Ngreu, o babë, se të kërkon kryetari i komunes së Vakeqes».

Kur i dëgjoi Saliu këto fjalë, desh vdiq në vend nga frika.

— Mos të ka thirrë sekretari, — e pyeti gjithë frikë, tue u mundue me ja largue përgjegjësinë vetes.

— Jo, jo, ti e thirre, — u përgjegj menjëherë Koçua.

— Jo, jo, unë s'e kam thirrë, — vazhdoi kryetari në atë të veten.

— Pyete çfarë kérkon, — i tha Koçua  
në vesh kryetarit.

— E çfarë kérkon? — pyeti me një  
gjysmë zani Saliu.

— Kam dy muej, që kam vdekë, —  
tha lugati dhe ngriti dy krahët përpjetë tue  
tundë çarçafin. Kryetar e sekretar mbërthyen  
njeni tjetrin e ranë përmbys nga frika. —  
Mos u trembni, mos u trembni — vazhdoi  
lugati. — Djali im Selimi më tha se kishte  
ardhë këtu, për të kerkue një dorë se unë  
baba i tij kam vdekë. Ju nuk i keni besue  
e keni kerkue që të vij unë që ta marr atë  
dorë. Ja, pra, ku erdha. — Prapë ngriti  
duert përpjetë.

— E çfarë do nga ne? — guxoi kësaj  
here e pyeti Koçua.

— Të më çregjistroni nga të gjallët.

— Koço, shpejt.

— Merre ti regjistrin, zoti kryetar, se e  
ke ma afër. Iu përgjegj tue u dridhë Koçua.

— Merre, të urdhëroj! — bërtiti me  
një fije zani kryetari.

Pa, ç'pa, Koçua mori regjistrin, bani  
çregjistrimin dhe i dorëzoi të vdekunit vërtetimin që kërkonte.

— E ke në rregull? — e pyeti i vdekuni.

— Siurdhëron. — i tha Koçua.

— Shiko, po nuk qe në rregull, unë  
vij prapë e mandej vaj halli për ju!

— Shikoje mirë, more dreq! — i bërtiti  
kryetari Koços.

Koçua i hodhi prapë një sy dhe vrap  
i vuni vulën.

Para se të dilte, Selimi ngriti edhe një  
herë krahet me gjithë çarçaf përpjetë. Vërriti  
«beee!» si cjapi dhe kaloi. E kuptioni vetë  
se çfarë banë burrat e komunes.

## PËRMBAJTJA

	Faqe
Dullë Kasemi — <i>Kolë Jakova</i> .....	3
Hallet e dasmës — <i>Fehmi Pali</i> .....	22
Hieja dhe shkolla — <i>Xhemal Veizaj</i> .....	29
Korrosaku — <i>Aristotel Mici</i> .....	54
Bualli i kënetës — <i>Miço Kallamata</i> .....	66
Selim Sakati — <i>Kolë Jakova</i> .....	87